

TEZË DOKTORATE

NORMATIVAT BAZË TË PROCESIT PROJEKTUES
APLIKIMI I TYRE NË REALIZIMIN E EKO-LAGJEVE NË SHQIPËRI ME
ANË TË METODOLOGJISË ZMEO

ERMIR GJOKA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS



Tezë në kërkim të gradës shkencore
“DOKTOR”

NORMATIVAT BAZË TË PROCESIT PROJEKTUES

APLIKIMI I TYRE NË REALIZIMIN E EKO-LAGJEVE NË SHQIPËRI ME ANË TË METODOLOGJISË ZMEO

Autor

MSc. Ark. Ermir GJOKA

Udhëheqës Shkencor

Prof. Dr. Andrea MALIQARI

TIRANË, 2016

JURIA

1.	Prof. Dr. Florian NEPRAVISHTA	Kryetar Oponent
-----------	--------------------------------------	----------------------------

2.	Prof. Asoc. Lumturi KAPLLANI	Anëtar
-----------	-------------------------------------	---------------

3.	Akademik Jorgaq KAÇANI	Anëtar
-----------	-------------------------------	---------------

4.	Prof. Asoc. Hasan JAHO	Anëtar Oponent
-----------	-------------------------------	---------------------------

5.	Prof. Dr. Bashkim ÇELA	Anëtar
-----------	-------------------------------	---------------

Tiranë, më ____ / ____ / 2016

FALENDERIME

Këtë punim ja kushtoj prindërve dhe familjes sime.

Falenderoj Udhëheqësin Shkencor **Prof. Dr. Andrea MALIQARI**
Prof. Dr. Florian NEPRAVISHTA dhe të gjithë kolegët e **Fakultetit të Arkitekturës**
dhe Urbanistikës të Universitetit Politeknik të Tiranës

Mirënjohje e veçantë për **Prof. Dr. Domenico POTENZA**

PËRMBAJTJA

SUMMARY	2
Kapitulli I: KONTEKSTI	3
1.1 Hyrje	4
1.2 Identifikimi i problemit	5
1.3 Realiteti shqiptar, normativat dhe problematikat e ndryshme	6
Kapitulli II: BAZA LIGJORE, SYNIMET DHE PRINCIPET	11
2.1 Principet dhe Roli i Arkitekturës së Qëndrueshme	12
2.2 Synimet Ndërkombëtare mbi Qëndrueshmërinë dhe Referenca Ligjore Evropiane	16
2.3 Aktorët dhe Etapat kryesore të Zhvillimit të Qëndrueshëm në shkallë botërore	27
2.4 Burimet energjetike të ripërtëritshme	33
2.5 Çertifikimi energjetik; mjetet, normat dhe nismat e ndërmarra në këtë fushë	40
Kapitulli III: METODOLOGJIA E VLERËSIMIT DHE MONITORIMIT NË LAGJET E QËNDRUESHME	42
3.1 Kriteret dhe Strategjitë e Vlerësimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm	43
3.2 Filozofia dhe zbatimi i metodologjisë “Zmeo” në realizimin e eko-lagjeve	45
Kapitulli IV: HIPOTEZË APLIKIMI	67
4.1 Propozim i Lagjeve të Qëndrueshme në një zonë të degraduar të qytetit të Tiranës	68
4.2 Aplikimi i Metodologjisë Zmeo në projektet e propozuara për Lagjet e Qëndrueshme në Tiranë	79
Kapitulli V: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	96
BIBLIOGRAFIA	101
SITOGRAFIA	103
SHKURTIME DHE AKRONIME	104
LISTA E ILUSTRIMEVE	105
LISTA E TABELAVE	106
LISTA E GRAFIKËVE	107

Summary

During the last 20 years in Albania, primarily observed in big cities, the housing quality, residential arrangement and urban development policies have resulted in a confusing state. Starting from the change of domestic lifestyle, housing demands and the change of relation between private and public space, the problem here after is strongly related to mobility, transport, traffic and population dynamics (ongoing demographic change, migration and the considerable growth of urban population). A series of factors related to failure come from the inability of competent administrative institutions and government to deal with these problems based on old directives and planning standards. In Albania, although construction has made a rapid progress in recent years, directives and construction technologies still remain very primitive compared to developed countries, which strongly support and apply the concept of "Sustainable Architecture and Urban Development".

For many years architects, engineers and researchers have introduced and claimed the application of a series of directives and innovative systems whose results have had noticeable impacts.

The principal aim of this study is the integration of "advanced technological strategies and applications" based on updated European Standards and Directives such as: building placement, material sustainability requirements, heating, ventilation and cooling system efficiency, solar panels, wind turbines, solar water heating, recycled materials, waste management, rainwater collectors etc, in an urban area of Tirana. The result of the optimal utilisation of the above-mentioned strategies and that of natural elements as moderating elements of microclimate is "The Eco-Village", complex neighbourhoods designed to ensure comfort within the dwelling as well as within the neighbourhood itself.

The research examines the feasibility and viability of eco-neighbourhood planning in a neglected area of the city, presenting an approach to enhance sustainability, a potential to tackle climate change and to facilitate the transition to a "green" economy through energy efficiency. The approach is framed into two main sections: (1) the proposal of a new eco-neighbourhood in neglected empty plots and (2) Sméo methodology- a tool that helps decision-making process for sustainability assessment of neighbourhood projects or buildings.

The proposed model promotes the launch of the eco-innovative concept in the Albanian urban planning and building sector. This strategy would set the initial steps and standards to the long-term perspective of low energy cities and better quality of life.

Keywords: *Eco-Neighbourhood, Tirana, Urban Design, Standards and Norms, Sustainable Design, Sméo Methodology.*

Kapitulli I

KONTEKSTI

1.1 Hyrje

Popullsia botërore është në rritje të vazhdueshme dhe brenda vitit 2050 do të arrijë shifren 9,6 miliardë njerëz, pjesa më e madhe e të cilëve do të jetojë në megalopoli të vendeve në zhvillim. Rritja demografike, diferenca ekonomike midis vendeve të pasura dhe të varfëra, ashtu si dhe luftrat dhe ndryshimet klimaterike, do të çojnë në një rritje kostante të numrit të migrantëve. Në të njëjtën kohë vazhdon edhe lufta kundër varfërisë, ku në vendet në zhvillim, që nga viti 1990 deri në vitin 2005, u arrit reduktimi i përqindjes së personave që jetonin me më pak se një dollar në ditë (nga 46% në 27%). Edhe pse numri i të pasurve është në rritje të vazhdueshme, rritja e numrit të individëve në varfëri ekstreme¹ vazhdon të jetë më e lartë.

Konkurenca midis poleve ekonomike me interes është në rritje. Në Evropë, kriza e Euro-s dhe borxhit ka nxjerrë në pah mangësi të thella të strukturave, gjë që kompromenton seriozisht konkurrencën mes vendeve evropiane. Ndërkohë që “*shteti-komb*” humb ndikimin e tij, rritet fuqia e shoqërive dhe institucioneve shumëkombëshe ekonomike si: **Organizata Botërore e Tregtisë (WTO)**², **Fondi Monetar Ndërkombëtar (IMF)**³ ose **Banka Botërore**.

Shpërndarja e punës në shkallë botërore është gjithmonë e më në rritje. Vendet ekonomikisht të forta shndërrohen në “*shoqëri e ndërgjegjes*”, mirëqenia e të cilave bazohet në rritjen e dijes dhe në përdorimin e teknologjive të reja të informacionit dhe komunikimit. Në të njëjtën kohë, prodhimi industrial transferohet gjithmonë e më shumë drejt vendeve në vështirësi dhe në zhvillim.

Në nivel global, problemet mjedisore kryesore të shekullit të XXI-të janë të lidhura me ndryshimet klimaterike dhe me katastrofat natyrore gjithmonë e më të shpeshta, me mungesën e ujit të ëmbël, me degradimin e shumëllojshmërisë së specieve (*biodiversitet*), me ndotjen e oqeanëve dhe brigjeve detare, me humbjen masive të terrenit agrar si dhe me rreziqet kimike, bërthamore dhe të inxhinierisë gjenetike të lidhura me mënyrat tona prodhuese dhe me traditat tona të konsumit. Burimet natyrore janë gjithmonë e më të kërkuara për shkak të rritjes së kërkesës për konsum nga ana e vendeve nordike por edhe e vendeve në zhvillim të shpejtë si p.sh; Kina dhe India.

Nga ana tjetër, volumi i çështjeve industriale botërore të ndërtimeve arrin në më shumë se 3 milion miliard dollarë amerikan dhe zë 10% të Prodhimit të Brendshëm Bruto botëror. Ndërtimi është sektori industrial më i rëndësishëm në SHBA (12%) dhe Evropë (10-11% e **PBB**)⁴ dhe nga ana tjetër aktiviteti njerëzor me impakt më të lartë mbi mjedisin, i përgjegjshëm për 40% të konsumit të energjisë dhe të rrjedhojave si ndotja mjedisore dhe gazi serë.

¹ ICSD - Interdepartmental Committee on Sustainable Development

² WTO - World Trade Organization

³ IMF - International Monetary Fund

⁴ PBB - Prodhimi i Brendshëm Bruto

1.2 Identifikimi i problemit

Nëse marrim parasysh evoluimin e çështjes së qëndrueshmërisë mjedisore deri në ndërrimin e mijëvjeçarit, jo më dhe jo vetëm si problematikë sociale, por si disiplinë të arkitekturës dhe urbanistikës pra, si menaxhim modern i mjedisit urban, mund të pohojmë se vetëm prej pak vitesh çështja ekologjike është vënë në qendër të botës së kulturës arkitektonike, në veçanti në atë akademike. Vetëm disa prej përbërësve të saj (*në veçanti në sektorin e teknologjisë së arkitekturës*) dhe disa figura më të ndieshme janë zotuar në fillim me thellime teknike, refleksione kritike dhe projekte specifike për të përballuar nga ana inovative temën e qëndrueshmërisë. Problemi qëndron në faktin se, që mbas luftës së dytë botërore, deri mbas rënies së Murit të Berlinit, mendimi arkitektonik në përgjithësi, ka privilegjuar një organizim që synonte një modernizim të keqkuptuar të qyteteve tona, e gjithë kjo në kundërshtim me një sjellje dhe sensibilitet të tipit ekologjik.

Kultura e viteve ‘900 e Lëvizjes Moderne ka lartësuar rolin social të arkitekturës duke ndjekur një barazi teorike utopike krejt të pandjeshme ndaj një marrëdhënieje korrekte me mjedisin që tradicionalisht ka pas qenë një themel i zakonit arkitektonik ndërtimor. Me ardhjen e mijëvjeçarit të ri, qëndrueshmëria ka fituar një pozicion qendror në botën e arkitekturës, pothuajse me qëllim zëvendësimin e vlerës së barazisë utopike të Lëvizjes Moderne me një lloj të ri utopie nga e cila duket se arkitektët as munden, as nuk duan të heqin dorë. Në fakt, duket se ka ardhur momenti ku një sjellje e re etike të jetë rruga e duhur për të ndrequr gabimet e qytetit modern, dhe ku përgjegjësia ekologjike të jetë vula e kësaj sjelljeje. Kemi nevojë për një sjellje minimaliste dhe antiautoritare: rindërtimi i botës çdo ditë, riorganizimi dhe ripërshtatja e mjedisit duke respektuar çdo diversitet; një utopi liberale si ajo e rekomanduar dhe praktikuar nga **Lysien Kroll** (*Lucien Kroll*), e orientuar drejt marrëdhënieve dhe jo drejt objektit, që synon ruajtjen e identitetit individual dhe solidaritetin e grupit human përmes memorjes dhe natyrës. *“Në urbanistikën evropiane kanë bashkëjetuar gjithmonë dy tradita: ajo e orientuar drejt objektit dhe ajo e orientuar drejt marrëdhënieve. Metoda e parë është ndërtuar kryesisht në brendësi të punës moderne për racionalizim e cila dështoi në gjysmën e dytë të shekullit të XX. Metoda e dytë ka përpunuar njohuritë dhe mënyrat e veta vepruese më parë në brendësi të sistemeve intuitive mijëvjeçare dhe së fundmi edhe në arsyetimin iluminar që shkencat humane projektojnë në veprimet komplekse, në parregullsitë dhe në efektet e tyre; duke përgatitur kështu kushtet për shekullin e XXI”*⁵.

Mendimi shkencor shthur çdo paragjykim, eviton çdo mospranim, çdo limit të sjelljes, mbështet të drejtën e mbizotërimit të artificiales mbi natyralën, kështu njeriu bëhet viktimë e vetvetes; iluzioni teknologjik e çon atë në një arrogancë qorre, e shtyn drejt iluzionit se mund të sulmojë pa kriter mjedisin dhe ta qeverisë atë me burimet e teknikës. Kështu, në Shqipëri, arkitektët të cilët vepruan sëfundmi në qytetet tona, e lanë pas dore vizionin e raportit njeri-mjedis, prodhuan “*volume*” të cilat përjashtuan njeriun dhe ndjenjat e tij nga vlerat bashkëkohore të arkitekturës së qëndrueshme.

⁵ (Kroll 2001). - (L.C.)”.

Në ditët e sotme, inquadrohet një filzofi e cilësisë mjedisore që çon projektin në ndërgjegjen dhe vlerësimin e rrjedhëve që mund të ketë mbi jetën e njeriut. Përmes iniciativave të ndryshme të Klubit të Romës, të Konferencës së Kombeve të Bashkuara të Stokholmës me'72, të Konferencës së Rios me'92, çështja ekologjike është vënë në qendër të debateve sociale, kulturore dhe politike, duke u bërë një shqetësim i përgjithshëm në shkallë botërore. Megjithëse, duhet theksuar se në sensibilizimin e qytetarëve dhe politikanëve mbi rëndësinë e çështjes ekologjike kanë influencuar disa ngjarje të rënda dhe katastrofike të fundshekullit të kaluar, që nga kriza e naftës në Lindjen e Mesme deri në aksidentet tragjike të Sevezo (Seveso), Bopal (Bhopal), Çernobil (Cernobyl).

1.3 Realiteti shqiptar, normativat dhe problematikat e ndryshme

Në 25 vitet e fundit në Shqipëri industria e ndërtimit u kthye në një nga sektorët më dinamikë të ekonomisë së vendit. Në fakt, në këtë periudhë pati më shumë ndërtime sesa në të gjithë historinë e vendit tonë. Kjo e dhënë ka dy interpretime: një interpretim pozitiv, pra prodhimi dhe punësimi e një interpretim kritik që nënvizon anomalinë shqiptare që katalizon investimet prodhuese të një sektori me përmbajtje të ulët teknologjike të cilat në Shqipëri duhet t'i përkasin sektorëve industrialë me teknologji të avancuar. Përveç numrit të lartë të ndërtimeve të rregullta, ndërtimet pa leje kanë qenë një tipar dallues i peizazhit urban, duke e klasifikuar kështu territorin shqiptar si një nga më të dëmtuarit në Evropë.

Normat dhe standartet e vjetëruar të ndërtimit çuan në paaftësinë e organeve përkatëse në parandalimin e shumë faktorëve negativë si: rritja mbi limitin maksimal të intensitetit të shfrytëzimit të ndërtimit nga etja për fitime të larta të ndërtuesve; ndërtimet pa kriter, jo sizmike; mos respektimi i distancave të sigurisë midis ndërtesave; betonizimi i hapësirave të gjelbërta dhe zbavitëse; zhdukja e parkingjeve publike. Në fakt, rreth 75% e ndërtimeve në vend janë të ndërtuara me një teknologji të vjetëruar tashmë, jashtë çdo standarti Evropian. Në ato vite nuk ekzistonte kujdes ndaj temave mjedisore, ndërsa zhvillimi i qëndrueshëm as që imagjinohej.

Konsumimi i lartë i sipërfaqes së parcelave brenda qytetit, shoqëruar nga çmimi i lartë i tyre dhe nga vështirësitë e marrjes së lejeve të ndërtimit, çoi në shpërhapjen e ndërtimeve drejt periferisë. Tendencia për shpërhapje territoriale duke nënvleftësuar funksionalitetin e aplikuar në projektimin e hapësirave urbane, është në kundërshtim me principin thelbësor të ekuilibrit afatgjatë, bazë e zhvillimit territorial të qëndrueshëm. Një tjetër problem kryesor është infrastruktura dhe transporti publik. Cilësia e dobët e transportit publik i ka detyruar banorët të pajisen me automjete private, gjë që ka sjellë me vete një sërë problemesh, përfshirë dëme të mëdha në mjedis dhe shëndet. Të dhënat janë të qarta, por në Shqipëri ende nuk ekzistojnë strategji politike në lidhje me këtë problematikë.

Ndër rrjedhojat negative të shpërhapjes territoriale mund të citojmë:

- konsumimin e terrenit nga shpërhapja e ndërtimeve
- një impakt të fortë mbi mjedisin
- tendencën në rritje të pabarazisë social-kulturale
- kosto kolektive më të larta.

Konventa Ndërkombëtare i klasifikon vendet në tre grupe kryesore ku Shqipëria bën pjesë në vendet e **Aneksit Jo-1** (tabela 1).

“Bashkë, por përgjegjësi të ndara”

ANEKSI 1	ANEKSI 2	JO të ANEKSIT 1
Vendet e industrializuara, Ekonomitë në Tranzicion (EITs)	Vendet e Industrializuara	Vendet në Zhvillim
• Ndërmarrin politika dhe masa me synim reduktimin e emetimeve të GHG-ve në nivelet e vitit 1990. • EITs kanë “fleksibilitet” në angazhime.	• Sigurojnë burime financiare për të përkrahur vendet në zhvillim. • Nxisin transferimin e teknologjive. • Palët që nuk janë anëtare të Aneksit 1.	• Nuk kanë detyrime sasiore. • Vendeve më pak të zhvilluara u është dhënë një trajtim i veçantë.

Tabela 1. Kriteret e tre gupeve kryesore

Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC)⁶ raporton në vitin 2014 këto të dhëna për Shqipërinë që pasqyrohen në tabelat dhe grafikët në vijim (grafikët 1, 2):

⁶ UNFCCC United Nations Framework Convention on Climate Change



UNFCCC Country Brief 2014: Albania

A. Key Country Indicators

CO2 emissions from fuel combustion ¹ (2012)	Global Rank 121	Global share 0.01%	3.8 Mt CO2 Eq.
Population ² (2013)	139	0.04%	2.77 Million
CO2 emissions / Pop. ¹ (2012)	107		1.21 tCO2 per capita
GDP Size ² (2013)	117	0.03%	Based on PPP
GDP Size ² (2013)	125	0.02%	Based on exchange rates
UNDP human development index ³ (2012)	70		
GDP Structure ³ , % (2013)	Agriculture: 22, Industry: 15, Services: 63		
Share of GDP ³ , % (2013)	Imports: 53, Exports: 35		

B. CO2 Emissions and Related Indicators


	Trend 1990-2012	1990	2000	2005	2010	2012	Change (%) 1990-2012	Growth rate (% per year) 1990-2012
Population ²		3,286,542	3,089,027	2,992,724	2,856,673	2,801,681	-14.8	-0.7
GDP (billions 2005 USD PPP) ²		12.86	14.74	19.17	24.55	25.69	99.8	3.2
TPES (Mtoe) ¹		2.67	1.76	2.17	2.11	2.07	-22.4	-1.1
CO2 emissions from fuel combustion (Mt) ¹		6.25	3.05	3.97	3.90	3.83	-38.7	-2.2
GHG emissions (Mt CO2 eq.) ⁴		11.10	7.61	8.36	8.67	-	-	-
GDP / Pop. (2005 USD PPP per capita)		3,913	4,772	6,406	8,594	9,169	134.3	3.9
TPES / Pop. (toe per capita)		0.81	0.57	0.72	0.74	0.74	-8.9	-0.4
CO2 fuel comb. / Pop. (t CO2 per capita)		1.90	0.99	1.33	1.37	1.37	-28.1	-1.5
CO2 fuel comb. / GDP (kg CO2 / 2005 USD PPP)		0.49	0.21	0.21	0.16	0.15	-69.3	-5.2

C. Energy Profile¹

	Trend 1990-2012	1990	2000	2005	2010	2012	Change (%) 1990-2012	Ratio of imports/exports to production (%) 1990	2012
Energy production		2.46	0.99	1.13	1.62	1.67	-32.1	-	-
Energy imports		0.29	0.84	1.14	1.35	1.36	367.1	11.9	81.7
Energy exports		0.12	0.02	0.05	0.75	0.98	709.5	4.9	58.4

	Trend 1990-2012	1990	2000	2005	2010	2012	Change (%) 1990-2012	Share of TPES (%) 1990	2012
Oil		1.21	1.00	1.42	1.21	1.06	-13.0	45.4	50.9
Oil Shale		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	-	0.0	0.0
Coal		0.63	0.02	0.01	0.11	0.16	-74.21	23.6	7.8
Peat		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	-	0.0	0.0
Gas		0.20	0.01	0.01	0.01	0.01	-93.49	7.6	0.6
Hydro energy		0.24	0.40	0.46	0.65	0.41	65.91	9.2	19.6
Nuclear energy		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	-	0.0	0.0
Combust. renewables & waste		0.36	0.26	0.23	0.20	0.21	-43.11	13.6	10.0
Wind/Solar/Geothermal		0.00	0.00	0.00	0.01	0.01	-	0.0	0.6
Other (electricity trade)		0.02	0.09	0.03	-0.08	0.22	1132.04	0.7	10.5
TPES		2.67	1.76	2.17	2.11	2.07	-22.38	100.0	100.0

D. CO2 Emissions by Fuel Type¹




^[1] Source : International Energy Agency (IEA)
^[2] Source : World Bank, World Development Indicators
^[3] Source : UNDP, Human Development Indicators

^[4] Source : Emissions Database for Global Atmospheric Research (EDGAR)

Grafiku 1: UNFCCC. Të dhënat mbi Shqipërinë 2014



E. Trends in CO₂ Emissions by Sector⁵




F. Emissions by sector⁶


Latest year for which data (submitted to the UNFCCC as part of a National Communication or inventory submission) is available

1994

Category	GHG Emissions (kt CO ₂ eq.)
1. Energy	3,104.98
2. Industrial Processes	209.87
3. Solvents	-
4. Agriculture	1,879.28
5. LULUCF	-
5bis Land-Use Change and Forestry	1,525.46
6. Waste	339.74
7. Other	-
GHG Total with LULUCF	7,059.33
GHG Total without LULUCF	5,533.87



G. Emissions of CO₂, CH₄, N₂O, HFCs, PFCs and SF₆⁷



H. Further Information

[UNFCCC GHG Data Interface](#)
[Annual GHG Inventory Submissions](#)
[Submitted INDCs](#)
[Sixth National Communications](#)
[Submitted Biennial Reports](#)
[Focal Point and Ratification Status of the Convention and the Protocol](#)

[IEA Data Services](#)
[World Bank Data](#)
[UNDP Open Data](#)
[EDGAR](#)

^[5] Source : International Energy Agency (IEA)
^[6] Source : UNFCCC
^[7] Source : Emissions Database for Global Atmospheric Research (EDGAR)

Deri më tani Shqipëria ka:

- ratifikuar **Konventën Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike**, (UNFCCC) në 1994 dhe Protokollin e Kioto-s⁷ (*Kyoto*) në 2005 me ligjin nr. 9334, datë 16.12.2004;
- nënshkruar 7 Konventa Ndërkombëtare për çështje të ndryshme mjedisore;
- hartuar 23 ligje në mbrojtje të mjedisit, biodiversitetit, florës e faunës, etj;
- hartuar 20 ligje për ratifikime e aderime nëpër Protokolle Ndërkombëtare, Marrëveshje, Amendamente, etj;
- hartuar mbi 80 VKM që lidhen drejtpërsëdrejti me mjedisin, etj.

Megjithatë, askush nuk duket se ka ndërmend të marrë përsipër introduksionin e kriterëve të reja që do të kishin një efekt kontrolli për t'i dhënë këtij sektori industrial një trend pozitiv. Politika e menaxhimit të territorit është shumë e prapambetur dhe konfuze. Ligjet urbanistike në fuqi nuk marrin parasysh detyrimet dhe synimet që shumë shtete të avancuara kanë ndërmarrë vitet e fundit përta i përket shfrytëzimit të evoluimit të teknologjisë dhe aplikimit të detyrueshëm të principeve të qëndrueshëm në projektimin arkitektonik.

Institucionet në Shqipëri kur trajtojnë tematikat e zhvillimit të qëndrueshëm, e bëjnë këtë me artikuj shtesë, me më shumë fletë, me një gjuhë teknike komplekse pra më shumë shkurajuese. Kjo sjell një distancim të mëtëjshëm nga bashkëndarja dhe nga pjesëmarrja në tematika strategjike. I domosdoshëm është zbatimi i ligjeve dhe zotimeve të nënshkruara, dhe akoma më tej, vullneti për të çuar deri në fund nismat që ndërmerren për mbrotjen e mjedist. Megjithatë, edhe në hartimin e strategjive dhe përfshirjen e hapave për zbatimin e tyre ka ende shumë punë për t'u bërë, në mënyrë që të reflektohen të gjitha problemet që po has sot mjedisi në vend⁸.

⁷ Ligji Kyoto për Shqipërinë Nr.9334, datë 16.12.2004

⁸ <http://open.data.al/vështrim-i-përgjithshem-i-situatës-mjedisore-në-Shqipëri>

Kapitulli II

BAZA LIGJORE, SYNIMET DHE PRINCIPET

2.1 Principet dhe roli i Arkitekturës së Qëndrueshme

Në 1987 **Komisioni Botëror i Mjedisit dhe i Zhvillimit, “Komisioni Brandland” (Brundtland)**, përpunoi përkufizimin e mëposhtëm për konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm:

“Zhvillimi i Qëndrueshëm është ai zhvillim që i lejon brezit aktual të plotësojë nevojat e veta pa prekur mundësinë e brezave të ardhshëm të plotësojnë kërkesat e tyre”.

Që prej Konferencës së Rios më 1992, nocioni i zhvillimit të qëndrueshëm u përhap dhe u pranua njëzëri. Dy koncepte bazë janë themelore për të kuptuar domethënien e tij: koncepti i plotësimit të nevojave thelbësore të çdo individi, dhe ideja e ekzistencës së një limiti të qëndrueshmërisë të sistemit ekologjik global.

Burimi energjetik i qëndrueshëm më i madh në planet është energjia natyrore. E gjithë kjo ushqehet nga: dielli, era, uji, graviteti, baticat e zbaticat dhe ciklet hidrologjike. Kjo energji është e pafund, falas dhe është e vetmja energji e qëndrueshme. Energjia dhe burimet ndryshojnë në çdo rajon, në çdo lokalitet, në çdo vend e çdo kontekst: analizimi i kushteve klimatike tipike të vendit është shumë i rëndësishëm për projektin e qëndrueshëm. Projektimi me energjinë e ripërtëritshme lokale do të mundësojë krijimin e strukturave unike dhe tipike të lokalitetit që reduktojnë ose eliminojnë varësinë nga materialet dhe nga energjitë e papërtëritshme. Një organizëm i projektuar për të jetuar, do të përdorë, do të prodhojë, do të depozitojë, do të ripërtërijë burimet, do të pastrojë produktet e mbeturinave dhe do t'i rishpërndajë ato.

Nëse arkitektura e shekullit të XX bazohej në konceptin e projektimit ***“makina për të jetuar”***, sfida e arkitekturës në shekullin e XXI-të do të jetë projektimi ***“organizma për të qenë të banueshëm”***.

Projekti i qëndrueshëm është një sistem i cili ndihmon në zgjedhjen njëkohësisht të problemeve ***ekonomike, sociale dhe mjedisore*** (figura 1). Sa më shumë të integruara të jenë energjitë e qëndrueshme në mjedisin e ndërtuar, aq më shume ky do të jetë i qëndrueshëm. Qëndrueshmëria nuk është statike, por ndryshon vazhdimisht pasi bazohet në evoluimin e dijes që lidh shkencën me projektin.




Figura 1: Fushat referuese të zhvillimit të qëndrueshëm

Udhëzime për zhvillimin e qëndrueshëm:

- **Përgjegjësi për të ardhmen**
Nevojat e brezave të tashëm duhen përmbushur pa prekur mundësitë e brezave të ardhshëm për ti bërë ballë nevojave të tyre.
- **Marrje parasysh në mënyrë të ekuilibruar të tre përmasave të zhvillimit të qëndrueshëm**
Politika duhet të ndjekë synimet: “përgjegjësi ekologjike”, “efikasitet ekonomik” dhe “solidaritet social”. Ajo gjithashtu kërkon zgjidhje perfeksionizimi duke siguruar një barazpeshim të konflikteve të interesit.
- **Integrim i zhvillimit të qëndrueshëm në të gjitha politikat sektoriale**
Zhvillimi i qëndrueshëm duhet integruar tërësisht në të gjitha politika sektoriale.
- **Intensifikim i koordinimit mes politikave sektoriale dhe përmirësim i koherencës**
Strategjia për një zhvillim të qëndrueshëm duhet të zbatohet në mënyrë trasversale, përtej kufijve të zyrave lokale.
- **Realizim i zhvillimit të qëndrueshëm nëpërmjet pjesëmarrjes**
Përfshirja e bashkive, pjesëmarrësve të sektorit privat dhe shoqërisë civile.

Strategjia për një zhvillim të qëndrueshëm përmban një plan veprimi me një spektër të gjerë fushash veprimi dhe masash konkrete për t’u marrë me qëllim realizimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

- **Klima dhe rreziqet natyrore**
Përveç objektivit të reduktimit të emetimeve duhen ndërmarrë masat e duhura për menaxhimin e rrjedhjeve të ndryshimeve klimaterike.

- **Energjia**

Një përdorim i qëndrueshëm i burimeve energjetike do të thotë të përmbushen nevojat e ekonomisë dhe shoqërisë duke shfrytëzuar energjinë në mënyrë më të arsyeshme, pra duke reduktuar sa më shumë konsumin e burimeve dhe aty ku është e mundur duke përdorur energjitë e përtëritshme.

- **Zhvillim i qëndrueshëm i territorit**

Proceset që kanë një impakt mbi territorin janë thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm: planifikimi i territorit duhet të garantojë përkufizimin e kërkesave territoriale për ekonominë, infrastrukturën efikase, një përdorim kursimtar të territorit dhe tutelën ndaj bazave natyrore të jetës.

- **Ekonomia, prodhimi dhe konsumi**

Bëhet fjalë për intensifikimin e përpjekjeve për t'a bërë vendin më konkurrues dhe në të njëjtën kohë për thellimin e debatit mbi një politikë ekonomike më të qëndrueshme. Nga pikëpamja e dimensionit shoqëror të zhvillimit të qëndrueshëm, nevojitet vendosja në plan të parë e shërbimit universal në fushën e infrastrukturave (*shërbimi publik*). Shpërblimet dhe kushtet kuadër të përshtatshëm mund të ndihmojnë në modernizimin e ekonomisë duke respektuar ambientin.

- **Përdorimi i burimeve natyrore**

Veçimi i shfrytëzimit të burimeve nga rritja ekonomike nuk është ende i mjaftueshëm. Presioni mbi burimet natyrore është në rritje për shkak të zhvillimit dhe modernizimit të ekonomisë, të transporteve, të teknologjive dhe të turizmit. Synimet kryesore janë mbrojtja e klimës, e biodiversitetit, e ujërave dhe e territorit.

- **Kohezion social, zhvillim demografik dhe migracion**

Në shumë raste, zhvillimi ka efekte negative mbi unitetin shoqëror. Për këtë arsye shteti duhet të krijojë kushtet e përshtatshme për të nxitur mundësitë e barabarta dhe pjesëmarrjen në jetën sociale dhe kulturore. Fenomene të padëshirueshme si psh; pabarazia e rrogave, varfëria, frika ndaj rrjedhëve të flukseve migratore të rregullta apo të parregullta mund të neutralizohen duke koordinuar më mirë politikën sociale.

- **Shëndeti i popullsisë**

Shëndeti mendor dhe fizik janë një domosdoshmëri për përmirësimin e cilësisë së jetës. Ato janë fortësisht të ndikuara nga mjedisi. Evoluimi i kostove të shëndetit rëndon mbi zhvillimin ekonomik dhe përfaqëson një faktor rreziku.

- **Sfida globale për zhvillimin e mjedisit**

Thellimi i pabarazive ekonomike dhe sociale në nivel global dhe lindja e varësive të reja midis krahinave të ndryshme të vendit përbejnë sfidën e zhvillimit të qëndrueshëm. Këto fenomene janë shpesh të lidhura me një abuzim të burimeve. Komuniteti Ndërkombëtar ka për detyrë të përcaktojë principin e rastësisë dhe të fiksojë rregulla në fushën e drejtësisë. E drejta e barabartë për aksesin ndaj burimeve

social-ekonomike, kusht që favorizon risinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm si dhe një ndryshim në sjellje nga ana e të gjithë pjesëmarrësve janë të domosdoshme për të mirë qeverisur sfidat në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin.

- **Financat publike**

Shteti ka nevojë për financime të shëndetshme për të pasur liri të mjaftueshme për të manovruar dhe për të plotësuar detyrat e veta. Nuk është e dëshirueshme, dhe prandaj duhet evituar fakti që brezat e ardhshëm të duhet të përballojnë rrjedhojat negative të shkaktuara nga brezat aktual. Nxitja për përdorim me kriter të burimeve do t'i lejojte politikës financiare të orientohej më shumë drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

- **Formimi, kërkimi dhe risia**

Për t'i bërë ballë një konkurrence ndërkombëtare gjithmonë e më të egër duhet të bazohemi mbi dijen. Kjo është e rëndësishme për të kuptuar ndërlidhjet midis shoqërisë, politikës, ekonomisë dhe mjedisit. Disa sektorë si, arsimi, kërkimi shkencor dhe teknologjia duhet të bazohen në një nivel formimi me cilësi të lartë, në një njohje të gjerë të botës, të kulturave të ndryshme dhe në një përditësim të vazhdueshëm.

Studimi dhe analiza e kontekstit dhe kushteve mjedisore të rajonit, ekologjia, biologjia, historia gjeologjike, antropologjia dhe klima, japin informacione domethënëse për projektimin e qëndrueshëm. Një analizë e qëndrueshme fillon me studimin e diellit dhe ndikimin e tij në rajon, në komunitet dhe vend. **Ralf Noules** (*Ralph Knowles*) në librin e tij **“Energjia dhe Forma”**⁹ përshkruan kontributin projektues të diellit në formë. Energjia diellore, toka dhe rrjedhat e ujit kanë qenë burime të qëndrueshme të vendit për shumë vjet: ata kanë gjeneruar në mënyrë spontane dhe pa kosto karakterin natyror dhe formën e vendit. Të veprorsh kundra modeleve natyrore është e kushtueshme, kërkon ndërhyrje mekanike të një niveli të konsiderueshëm dhe kjo është e papërballueshme. Modelet dhe karakteret natyrore janë unike në çdo vend dhe rajon dhe përfshirja dhe lidhja me ta do t'i sillte avantazhe projektit.

Një analizë e thelluar e vendit do të ndihmojë në percaktimin e:

- formës ideale dhe shkallës së ndikimit ndërtimor
- orientimit të ndërtesës
- pozicionimit, orientimit dhe dimensionimit të hapjes së nevojshme për dritën natyrore
- pozicionimit të hapjeve për ngrohje ose ftohje
- pozicionimit të dritareve për ventilim natyror
- materialeve dhe finiturave të përshtatshme ndaj ndikimit klimatik
- elementeve të peizazhit, dimensionimit, vendosjen dhe ndryshimin e tyre
- strategjive të koston së ulët si në ndërtim ashtu dhe për mirëmbajtje

⁹ Energy and Form i Ralph Knowles, Prof. i Merituar i School of Architecture, University of Southern California, University Park, WAH 204, Los Angeles, CA 90089-0291, USA



Figura 2: Skema e strategjive ndërhyrëse IN dhe OUT

Që ky sistem të funksionojë janë të nevojshme:

STRATEGJITË NDËRHYRËSE IN	STRATEGJITË NDËRHYRËSE OUT
- Shmangia e përdorimeve të panevojshme të energjisë - Përdorimi i burimeve të ripërtëritshme - Shmangia e përdorimeve të panevojshme të ujit	- Shmangia, riciklimi dhe ndarja e mbeturinave - Menaxhimi ndarës i ujërave dhe ripërdorimi i tyre

Tabela 2: Strategjitë Ndërhyrëse IN dhe OUT

Në projektimin e qëndrueshëm, për të arritur një cilësi arkitektonike përveç normave dhe kodeve të përditësuara, lind nevoja për të vepruar me kulturë të përgjegjshme në një optikë socializimi të teknologjive¹⁰. Kjo nënkupton parashikimin e skenarëve të mundshëm, ku demokratizimi i dijes shkencore ndihmon në zgjedhjet për banimin duke respektuar burimet e ndryshme kundër prodhimit të mbeturinave në sasi të mëdha.

“Arkitektura është e qëndrueshme kur arrin maksimumin e mirëqënies që mbart dhe vendoset në një ekuilibër harmonik me mjedisin me të cilin ndërthuret, sipas nevojave aktuale dhe të ardhshme”.

2.2 Synimet Ndërkombëtare mbi Qëndrueshmërinë dhe Referenca Ligjore Evropiane

Nevoja për të ndjekur një zhvillim të qëndrueshëm po shkakton ndryshime rrënjësore në politikat publike në mbarë botën. Cilësia e mjedisit konsiderohet si një karakteristikë thelbësore e mirëqënies në një shoqëri dhe për rrjedhojë si një karakteristikë thelbësore e kualitetit të zhvillimit ekonomik. Ndryshimet mbi mjedisin të provokuara nga aktiviteti njerëzor duhet të përmbahen brenda limiteve të caktuara për të mos dëmtuar në mënyrë të pandreqshme kontekstin biofizik global dhe për t'i lejuar jetës njerëzore të vazhdojë të zhvillohet. Kjo do të thotë që niveli i ndotjes dhe shfrytëzimit të burimeve mjedisore duhet të

¹⁰ Spiegelhalter 2008

qëndrojë në kufijtë e mundësisë që ka mjedisi marrës, për të asimiluar dhe për të rigjeneruar burimet sipas mundësive që lejon cikli i natyrës për të shmangur rritjen e ndotjes në kohë.

Sipas **Grupit Ndërqeveritar të Eksperteve mbi Ndryshimet Klimaterike (IPCC)**¹¹, për të përmbajtur rritjen e temperaturave nën 2°C dhe për të parandaluar rrjedhoja të rënda për njeriun, emetimet globale të gazit me efekt serë duhet të ulen me 50% brenda vitit 2050 (në krahasim me nivelet e vitit 1990). Vendeve të industrializuara ju kërkohet përpjekje më e madhe (reduktim i emetimeve me 80% e pse jo me 95% brenda vitit 2050). Gjithmonë sipas IPCC, që të evitohen konsequenca të pakthyeshme dhe në shkallë të gjerë për shkak të ndryshimeve klimaterike do të duhet të ndërhyet brenda vitit 2020.

“Gjurma ekologjike” e një vendi është një mjet llogaritës i burimeve pasurore që pasqyron bilancin ekologjik të një shteti dhe presionin e atij shteti mbi planetin. **Rrjeti Global i Gjurmëve (GFN)**¹² publikon çdo vit të dhëna për 201 shtete të botës¹³. Njësia matëse e përdorur është *“hektar për person” (gha)* (një **gha** është një hektar me një kapacitet të mesëm të përgjithshëm në prodhimin e burimeve dhe në asgjësimin e mbeturinave). Furnizimi i Evropës është rreth 2.2 *gha* për person, por konsumi i saj është më shumë se dyfishi i furnizimit, dhe është dyfishuar që nga viti 1960 (figura 3).

Nëse te gjithë banorët e botës do të jetonin si evropianët, atëherë do të duheshin dy planete për të siguruar burimet e nevojshme dhe për të absorbuar mbeturinat. Ekologjikisht, Evropa po kalon në bilanc negativ dhe është duke u shpëtuar nga vendet e varfëra të jugut të planetit. Lajm i mirë është se në Evropë ka ndodhur një shpërbërje e gjurmës ekologjike nga PBB-ja, por lajmi i keq është se indeksi i gjurmës ekologjike është ende në rritje në krahasim me indeksin e popullsisë.

Indeksi i Zhvillimit Njerëzor (HDI)¹⁴ ofron një alternativë ndaj PBB-së, si një tregues i kombinuar i mirëqenies njerëzore dhe shërben si një *“pikë-qasje”* e dobishme ndaj informacioneve të aspekteve të ndryshme të zhvillimit njerëzor. Indeksi i Zhvillimit Njerëzor i Kombeve të Bashkuara mat arritjet mesatare në një shtet sipas tre dimensioneve bazë të zhvillimit njerëzor (a) një jetë e gjatë dhe e shëndetshme (*matur nga jetëgjatësia në lindje*), (b) dituri (*matet nga shkalla e alfabetizimit dhe raporti i kombinuar bruto i regjistrimit në shkollat fillore, gjimnaze dhe universitare*), (c) një standard të mirë të jetesës (*matur me logaritmin e PBB-së për frymë në ppp*)¹⁵. Indeksi është ndërtuar nga Kombet e Bashkuara duke përdorur tregues aktualisht në dispozicion në mbarë botën, dhe kjo është pranuar gjerësisht si një masë e dobishme ndërkombëtare për mirëqenien njerëzore. (figura 4).


¹¹ IPCC - Intergovernmental Panel on Climate Change

¹² GFN - Global Footprint Network

¹³ <http://geodata.grid.unep.ch>, 2010

¹⁴ HDI - Human Development Index


¹⁵ <http://geodata.grid.unep.ch/>, 2010; <http://hdr.undp.org/en/statistics/>, 2010 Origin of data: Human development report © UMS RIATE for administrative boundaries



Ecological footprint, 2006
Global hectares per capita
divided by biocapacity (1.8 gha/hab)



Figura 3: Baza e të dhënave 2010, EPSON 2013. Harta e Gjurmës Ekologjike, 2006



EUROPEAN UNION
Part-financed by the European Regional Development Fund
INVESTING IN YOUR FUTURE

Sources: <http://geodata.grid.unep.ch/>, 2010;
<http://hdr.undp.org/en/statistics/>, 2010
Origin of data: Human development report
© UMS RIATE for administrative boundaries

Human Development Index (HDI), 2007





Figura 4: Baza e të dhënave 2010, EPSON 2013. Harta e Indeksit të Zhvillimit Njerëzor, 2007

Grafiku i shpërhapjes dhe hartat tregojnë pamjen e përgjithshme të vendeve përsa i përket Indeksit të Zhvillimit Njerëzor në lidhje me “gjurmën ekologjike” të vendit (grafiku 3).



Grafiku 3: Mirëqenia njerëzore në lidhje me gjurmën ekologjike

Vërehet se si me rritjen e HDI-së mbi një nivel të caktuar rritet edhe “gjurma ekologjike”. Për të arritur një zhvillim të lartë njerëzor, Kombet e Bashkuara konsiderojnë të nevojshme një HDI rreth 0.8 dhe një gjurmë mesatare globale 1.8 gha për person. Sipas klasifikimit të vitit 2009, Norvegjia kryeson në të gjithë botën. Pas saj vijnë Islanda, Irlanda, Holanda, Suedia, Franca, Zvicra, Luksemburgu, Finlanda, Austria, Spanja, Danimarka, Belgjika, Italia, Lihtenshtajn, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania dhe Greqia. Vendet e mbetura zotërojnë një HDI të lartë ku Rumania zë vendin më të ulët në renditje.

Analiza evropiane e ndryshimit klimaterik ka çuar në një lloj grupimi të vendeve me karakteristika të ngjashme. Tipe të ndryshme rajonesh janë identifikuar sipas profilit të tyre të ndryshimit klimaterik në bazë të një sërë treguesish ekspozimi (figura 5).




Figura 5: Harta e Ndryshimit të klimës në Evropë, 1961-2100

Në të gjithë Evropën Qëndrore-Jugore skenari parashikon se ndryshimet kryesore do të jenë: rritje e fortë e temperaturave mesatare dhe e numrit vjetor mesatar të ditëve të verës; rënie e fortë e numrit vjetor mesatar të ditëve me ngrica; dhe rënie e fortë të reshjeve të verës.

Për rajonet në Evropën Veriore: rritje e fortë e temperaturës mesatare, por edhe e reshjeve mesatare vjetore të dimrit; më shumë ditë me reshje të bollshme, më shumë avullim, por një rënie e fortë e numrit të ditëve me ngrica dhe borë. Evropa Qendrore-Veriore mund të përballlet me një rritje të moderuar të temperaturave mesatare, numrit vjetor mesatar të ditëve të ngrohta, reshjeve mesatare vjetore në muajt e dimrit dhe avullimit vjetor mesatar. Do të ketë një rënie të fortë të numrit të ditëve me acar, më pak ditë me dëborë dhe një sasi të reduktuar të reshjeve në verë. Për rajonin e Mesdheut pritet një rritje e fortë e temperaturave mesatare dhe e numrit vjetor të ditëve të ngrohta së bashku me një rënie të fortë të reshjeve në muajt e verës dhe në mënyrë të ngjashme një rënie të fortë të ditëve me acar. Në Evropën Veri-Perëndimore ka më shumë ditë me shira të rrëmbyeshëm, me shumë shi gjatë dimrit, por më pak shi gjatë verës, temperatura vjetore mesatare më të larta dhe më shumë ditë të ngrohta, më pak ditë me acar.

Natyrisht lind pyetja: si bëhet i mundur shfrytëzimi i mjedisit dhe në të njëjtën kohë mbrojtja e tij?

Përgjigjja qëndron kryesisht në progresin teknologjik që mund të lejojë uljen e koeficientëve të shfrytëzimit të mjedisit për njësi prodhimi ose shërbimi. Nëpërmjet integritit dhe përhapjes së teknologjive më të pastra të aplikuara në fazat fillestare të proceseve prodhuese që reduktojnë intensitetin e ndotjes dhe nëpërmjet teknologjive më efikase për shkatërrimin në fazat përfundimtare që rrisin procesin e rekuperimit të mbeturinave dhe mbetjeve, mundësohet reduktimi i konsumit energjetik, përmirësohet shfrytëzimi i burimeve, etj.

Sipas përvojës dhe reflektimit teorik, në ekonominë e avancuara ekzistojnë tendenca spontane drejt qëndrueshmërisë, por që shfaqen të pjesshme dhe të pamjaftueshme. Pra, duke qenë se zhvillimi i qëndrueshëm nuk është diçka automatike dhe spontane, janë të nevojshme politika publike të përshtatshme për të favorizuar investime specifike në teknologjitë mjedisore nga ana e ndërmarrjeve, me qëllim reduktimin e impaktit të tyre mbi mjedisin. Në fakt, këto të fundit jo gjithmonë stimulohen në mënyrë të duhur nga tregu për të investuar në drejtimin e duhur dhe si rrjedhojë, është detyrë e politikës ekonomike të plotësojë mungesat e tregut. Kuota kapitale e investuar në reduktimin e koeficientit të shfrytëzimit të mjedisit për njësi produkti është sigurisht në funksion të rritjes së çmimit të caktuar për shfrytëzimin e mjedisit, ose të avantazheve të arritura nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të performancës mjedisore. Për këtë motiv, në brendësi të politikave publike, mjeteve administrative të ***“comand and control”*** të bazuar në rregullat e drejtpërdrejta (*norma ligjore për të imponuar sjellje të caktuara dhe standarte, të ndjekura nga mekanizma kontrolli dhe sanksione*) të cilave u është konstatuar pamjaftueshmëria, po ju bashkangjiten mjete të tipit ekonomik si përshembull: taksat (*ose tarifat*) mjedisore, masat e nxitjes për integrimin e teknologjive të pastra dhe me tryzni më të ulët mbi mjedisin (*lehtësime tatimore, kontribute në llogari kapitale etj*), dhe mjete të llojit vullnetar si **Eko-Menaxhimi dhe**

Skema e Auditimit (EMAS)¹⁶, të bazuara në dinamikat e tregut për të favorizuar një marrëdhënie të re mes ndërmarrjeve, institucioneve dhe publikut bazuar në transparencën, në mbështetjen reciproke dhe në bashkëpunimin. Shumë ndërmarrje i janë bashkuar që prej vitit 1991 *"Dokumentit të Ndërmarrjeve për një Zhvillim të Qëndrueshëm"*, zotim që u lejon ndërmarrjeve të arrijnë një farë shkalle të përshtatshmërisë mjedisore.

Për sa i përket orientimit të Komunitetit Evropian në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm duhet të shihet **Dekreti. n. 2179/98/CE i 24 shtator 1998**, vendim ky i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit në lidhje me riezaminimin e programit komunitar politik dhe veprimtarisë në favor të mjedisit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm *"Për një zhvillim afatgjatë dhe të qëndrueshëm, njeriu duhet të gjejë ekuilibrin në mjedisin e vet dhe të korrigjojë dëmet e mëparshme"*¹⁷.

Në nivel administrativ, integrimi i zhvillimit të qëndrueshëm na lejon veçanërisht të:

- garantojë komunës një imazh premtues si sinonim i mirëqenies. Kjo ka edhe një ndikim ekonomik, sepse në këtë mënyrë komuna do të arrijë të tërheqë banorë dhe ndërmarrje të reja;
- përmirësojë funksionimin e administratës publike falë një analize tërthore dhe jo më vetëm sektoriale të shumë detyrave. Politikat e ndryshme të jenë më koherente dhe transparente. Në të njëjtën kohë, burimet njerëzore dhe financiare duhet të përdoren në mënyrë më efikase dhe duke ndjekur prioritetet e përcaktuara;
- komunikojmë më mirë, duke përmirësuar besimin dhe dialogun mes politikaneve, administratës publike dhe popullsisë. Në këtë mënyrë ky i fundit do të ketë mundësinë të shprehë vullnetin e vet edhe jashtë votimeve.

Mjetet dhe proceset në nivel bashkie janë:

- integrimi i konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm në rregulloren e bashkisë;
- integrimi i zhvillimit të qëndrueshëm në Planin e Përgjithshëm Vendor;
- dhënie përparësi zhvillimit të qëndrueshëm në direktivat e qeverisë;
- strategji bashkiake për një zhvillim të qëndrueshëm ose Agjenda 21 si program zhvillimi;
- integrimi i zhvillimit të qëndrueshëm në menaxhimin e politikave.

Një proces i qëndrueshëm nuk është një plan veprimi i përhershëm, por një proces në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Për të pasur një projektim të suksesshëm duhet që detyra e projektimit të bazohet në një sërë principesh të bazuara në një tabelë treguesish bazë (tabela 3).

¹⁶ EMAS - Eco-Management and Audit Scheme

¹⁷ Alvar Aalto, 1972, p.335

PRINCIPET E SISTEMIT TË TREGUESVE

Solidaritet Social

Principi kryesor	Garantim i të drejtave të njeriut	Çdo individ meriton një jetë dinjitoze dhe një zhvillim të lirë të personalitetit të tij, nëpërmjet sigurimit të demokracisë, të së drejtës dhe diversitetit kulturor.
	Kufijtë e lirisë së individit	Mundësia për zhvillim individual nuk duhet të paragjykojë dinjitetin njerëzor të individëve të tjerë të brezit aktual apo të brezave të ardhshëm.
Kushtet objektive të jetesës	Përbushje e nevojave	Duhet garantuar për kohë të gjatë përbushja e nevojave elementare të popullatës.
	Përparësi shëndetësive	Shëndeti i qenieve njerëzore duhet mbrojtur dhe favorizuar.
	Luftë kundër varfërisë	Një jetë dinjitoze përjashton varfërinë. Ndihma shoqërore për individët që jetojnë në kushte të vështira.
Kushtet subjektive të jetesës	Sodisfaksion dhe lumturi	Duhet stimuluar dhe respektuar dëshira për të jetuar dhe lumturi e brezave aktuale e të ardhshëm.
	Zhvillim i mirëqenies	Evoluimi social-ekonomik dhe ndryshimet mjedisore nuk duhet të ndikojnë negativisht në shëndetin fizik e psikik të individëve.
Shpërndarje e barabartë, mundësi të barabarta	Ndalim i çfarëdolloj diskriminimi	Asnjë nuk duhet të diskriminohet për karakteristikat e veta të brendshme apo të jashtme.
	Shpërndarje e barabartë, mundësi të barabarta	Çdo individ i shoqërisë duhet të ketë të njëjtat të drejta dhe mundësi. Duhet synuar një shpërndarje më e barabartë e burimeve.
	Integrim i të dobëve	Nevojitet inkurajim i integritetit të rajoneve dhe grupeve shoqërore të pafavorizuar në jetën ekonomike, sociale, kulturore dhe politike.
Përforsim i kohezionit shoqëror	Mirëkuptim mes individëve dhe kulturës	Duhet nxitur shkëmbimet e eksperiencave dhe mirëkuptimi mes individëve dhe grupeve.
	Pjesëmarrje shoqërore dhe politike	Nxitje e pjesëmarrjes sociale e politike.
Solidaritet ndërkombëtar	Kooperim për zhvillim	Bashkëpunimi për zhvillim duhet promovuar në nivel botëror, një zhvillim i barabartë duke reduktuar pabarazinë në shkallë globale ku në qendër të vëmendjes është lufta kundër varfërisë.
	Nxitje e paqes dhe demokracisë	Duhet inkurajuar bashkëjetesa paqësore e popujve dhe e kombeve dhe respektimi i të drejtave të njeriut dhe i institucioneve demokratike.
Zhvillim dhe mbrojtje e kapitalit njerëzor	Zhvillim i kapitalit njerëzor	Dituritë kolektive dhe trashëgimia social-kulturore duhen mbrojtur dhe vlerësuar.
	Liri e fjalës dhe informacionit	Duhet të garantohet qarkullimi i lirë i informacioneve dhe liria e mendimit.
	Inkurajim i arsimimit	Duhet të inkurajohet aftësia për të asimiluar dhe për të përpunuar informacionet.
	Mjedis i favorshëm për fëmijët	Në veçanti fëmijët dhe të rinjtë duhet të mund të jetojnë në një mjedis të hapur dhe stimulues që ju ofron perspektiva për të ardhmen.

Efikasiteti ekonomik

Principi kryesor	Rregull ekonomik në shërbim të të gjithëve	Sistemi ekonomik duhet të përmbushë realisht dhe me efikasitet nevojat në mënyrë që të stimulojë iniciativën individuale dhe të vendosë interesin personal në shërbim të të gjithëve.
Sistemi ekonomik	Ekonomi e tregut	Ndërhyrjet në tregun e lirë janë të justifikuara vetëm nëse tregu nuk kryen funksionin e vet ose nëse bëhet fjalë për të mira që kanë një interes publik predominant.
	Vërtetësi e çmimeve dhe principi i rastësisë	Çmimet duhet të reflektojnë veçantinë dhe rënien e vazhdueshme të burimeve dhe të përfaqësojnë kostot e jashtme (<i>principi i rastësisë</i>).
	Ndërhyrje në tregun e lirë konform me sistemin	Ndërhyrjet në tregun e lirë bazohen sëpari në mjete ekonomike.
Efikasitet dhe konkurrencë	Promovim i efikasitetit ekonomik	Duhet të përmirësohen dhe të rivlerësohen efikasiteti ekonomik i një shoqërie dhe kapitali i saj prodhues, social dhe human.
	Një ekonomi në favor të rrisë dhe konkurrencës	Kushtet kuadër të ekonomisë duhet të ruajnë dhe promovojnë rritjen, konkurrencën dhe cilësinë e biznesit.
	Inkurajim i kërkimeve shkencore	Duhet inkurajuar aktivitetet e kërkimit shkencor dhe të zhvillimit që përforcojnë zhvillimin e qëndrueshëm.
	Kufizim i borxhit publik	Borxhi publik mundësohet vetëm nëse nuk ndikon negativisht përmbushjen e nevojave të brezave të ardhshëm.
Fleksibilitet dhe stabilitet	Parashikim i ndryshimeve të sistemit	Kushtet kuadër të ekonomisë duhet të favorizojnë orientimin afatgjatë dhe të lehtësojnë përshtatjen ndaj ndryshimeve sociale.
	Shpejtësi e ndryshimeve të qëndrueshme	Shpejtësia e ndryshimeve të kushteve kuadër të sistemit ekonomik nuk duhet të përbëjë një rrezik për paqen në shoqëri.
Prodhim dhe konsum i të mirave dhe shërbimeve	Prodhim duke u bazuar në mjedis	Duhet minimizuar ndotja mjedisore e shkaktuar nga ndërmarrjet aktive në sektorin prodhues dhe rreziqet e lidhura si dhe duhet perfeksionuar flukset e energjisë dhe materialeve.
	Konsum sipas profilit shoqëror dhe mjedisor	Konsumi i të mirave dhe shërbimeve duhet të mund të përmbushë kriteret e barazisë sociale dhe përputhjes mjedisore.
	Informim transparent i ndërmarrjeve dhe konsumatorëve	Brenda dhe jashtë ndërmarrjeve duhet të vendosen sisteme informative që lejojnë një prodhimtari dhe një konsum të qëndrueshëm.
Punësim	Punësim vlerësues që lejon një jetesë dinjitoze	Sistemi ekonomik duhet t'u lejojë subjekteve që dëshirojnë të ushtrojnë një aktivitet pune të gjejnë një punësim që t'i vlerësojë dhe që të përmbushë nevojat e tyre.
Tregti ndërkombëtare	Tregti ndërkombëtare e përshtatshme me nevojat shoqërore dhe mjedisin	Sistemi tregtar multilateral duhet të favorizojë menaxhimin ekonomik dhe efikas të burimeve natyrore si dhe drejtësinë sociale.
	Tregti ndërkombëtare në ndihmë të të gjithëve	Sistemi tregtar multilateral duhet të nxisë përmbushjen e nevojave të një kombi pa dëmtuar nevojat e kombeve të tjera.

Përgjegjësi ekologjike		
Principi i përgjithshëm	Mbrojtje e burimeve natyrore	Duhet të ruhen për një kohë të gjatë bazat jetësore natyrore dhe të korrigjohen dëmet.
	Mbrojtje e biodiversitetit.	Duhet të mbrohet diversiteti dinamik i natyrës.
Përdorimi i burimeve	Kufizim i burimeve të përtëritshme.	Përdorimi i burimeve të përtëritshme duhet të mbahet nën nivelin e rigjenerimit të tyre.
	Kufizim i burimeve të papërtëritshme.	Përdorimi i burimeve të papërtëritshme duhet të mbahet nën potencialin për zhvillim të burimeve të përtëritshme.
Mbeturina dhe substanca	Kufizim i mbeturinave të biodegradueshme dhe agjentët ndotës.	Duhet të reduktuohet në minimum ngarkesa mjedisore e shkaktuar nga mbeturinat dhe nga emetimet e biodegradueshme. Ndotja nuk duhet të tejkalojë në asnjë mënyrë aftësinë për asimilim të ekosistemeve.
	Braktisje e agjentëve ndotës të padegradueshëm.	Emetimet e agjentëve ndotës të padegradueshëm në mjedis duhet të shmangen sa më shumë të jetë e mundur.
Rreziqe	Kompensim ekologjik.	Çdo dëmtim i natyrës duhet të kompensohet duke ndërmarrë masa paraprake që ruajnë cilësinë e biotopeve dhe vazhdueshmërinë e ekosistemeve.
	Minimizim i rreziqeve ekologjike.	Rreziqet ekologjike janë të tolerueshëm vetëm në atë sasi që nuk shkakton dëme të vazhdueshme për më shumë se një brez.
	Masa paraprake në rast pasigurie.	Është i nevojshëm parandalimi i dëmtimeve të rënda dhe të pakthyeshme mjedisore edhe atëherë kur nuk ekziston asnjë siguri shkencore absolute mbi rreziqet efektive.
Shpejtësi e ndryshimeve	Respekt për kohëzgjatjen e proceseve natyrore.	Ndërhyrjet e njeriut mbi mjedisin natyror duhet të jenë të proporcionuara me kohën që i nevojitet mjedisit për të reaguar me proceset natyrore dhe për t'u ripërtëritur.
Peizazhe natyrore dhe të kultivuar	Peizazhe natyrore dhe të kultivuar të denjë për t'u jetuar.	Dinjiteti njerëzor kërkon peizazhe natyrore dhe të kultivuar të denjë për t'u jetuar.

Tabela 3: Principet e Sistemit të Treguesve

2.3 Aktorët dhe Etapat kryesore të Zhvillimit të Qëndrueshëm në shkallë botërore

Në nivel ndërkombëtar, **Organizata e Kombeve të Bashkuara (UN)**¹⁸ ka qenë iniciatoria dhe nxitësja kryesore e zhvillimit të qëndrueshëm. Marrëveshjet e nënshkruara me anë të saj përfaqësojnë për proceset e zhvillimit të qëndrueshëm në shkallë botërore një bashkësi rregullash të një rangu superior. Ekzistojnë programe dhe organizata të ndryshme të OKB-së që veprojnë në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm: **Programi i Mjedisit i Kombeve të Bashkuara (UNEP)**¹⁹ me qendër në Nairobi (Kenia), **Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO)**²⁰, **Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO)**²¹ në Gjenevë, **Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP)**²², me qendër në Nju Jork. Për t'u veçuar rëndësia e **Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm (UNCSD)**²³. Ky komision deri tani ka shoqëruar dhe vëzhguar zbatimin e **Agjendës 21** dhe të **Planit të Zbatimit Johaneshburg**²⁴ (*Johannesburg*).

Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD)²⁵ me qendër në Paris përfshin vendet e industrializuara, pra luan një rol të rëndësishëm në politikën e zhvillimit të qëndrueshëm. Ajo jep rekomandime dhe baza shkencore që favorizojnë dialogun politik edhe në optikën e zhvillimit të qëndrueshëm. OECD-ja me strategjinë për një **“zhvillim të gjelbërt”** të 2011 ka prezantuar disa mjete (*p.sh; mjete të tregut*) për integrimin e principeve ekologjike në politikën ekonomike. Ndër temat e trajtuara në programin e punës mbi zhvillimin e qëndrueshëm gjejmë uljen e faktorëve dëmtues për mjedisin, përf forcimin e mjeteve të tregut (*shiko taksat ekologjike*), veçimin e rritjes ekonomike nga degradimi i mjedisit si dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve.

Edhe për Bashkimin Evropian zhvillimi i qëndrueshëm është një objektiv parësor që shërben si pikë referimi për të gjitha fushat politike dhe aplikimet përkatëse. BE-ja rekomandon të gjithë anëtarët të përpunojnë strategji kombëtare të bazuara në qëndrueshmëri. Pjesa më e madhe e tyre deri më tani ka respektuar këtë zotim. Në brendësi të **Rrjetit Evropian për Zhvillimin e Qëndrueshëm (ESDN)**²⁶ ekziston një shkëmbim intensiv eksperiencash dhe informacionesh që lejojnë përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të strategjive kombëtare.

¹⁸ UN - United Nations

¹⁹ UNEP - United Nations Environment Programme

²⁰ ILO - International Labour Organization

²¹ WHO - World Health Organization

²² UNDP - United Nations Development Programme

²³ UNCSD - United Nations Conference on Sustainable Development

²⁴ Johannesburg Declaration on Sustainable Development, A/CONF.199/20, Chapter 1, Resolution 1, Johannesburg, September 2002

²⁵ OECD - Organisation for Economic Cooperation and Development

²⁶ ESDN - European Sustainable Development Network

1972: LIMITI I ZHVILLIMIT

Debati mbi zhvillimi e qëndrueshëm ka filluar qysh me publikimin e raportit mbi gjendjen e njerëzimit të **“Klubit të Romës”** (*Club di Roma*) me titull **“Limitet e Zhvillimit”**²⁷, i cili pohon që një rritje e palimituar e burimeve fizike është e pamundur në një **“Sistem-Tokë”** të limituar.

1972: KONFERENCA E OKB-SË MBI MJEDISIN NË STOKHOLM (STOCKHOLM)

Firma e deklaratës së Stokholmës mund të konsiderohet akti fillestar i asaj që disa vite më vonë do të përkufizohej **“Zhvillimi i Qëndrueshëm”**.

“Një përmirësim afatgjatë i kushteve të jetesës ka nevojë për mbrojtjen e themeleve të jetës natyrore”.

1987: RAPORTI BRONTLAND (BRUNDTLAND)

Raporti Brontland (*Brundtland*) i njohur dhe si **“E Ardhmja Jonë e Përbashkët”** (*Our Common Future*) është një dokument i miratuar më 1987 nga **Komisioni Botëror mbi Mjedisin dhe Zhvillimin (WCED)**²⁸ ku për herë të parë, integrohet koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm.

“Zhvillimi i Qëndrueshëm është një zhvillim që plotëson nevojat e tashme pa dëmtuar mundësinë e brezave të ardhshëm të plotësojnë nevojat e tyre”.

1992: KONFERENCA E OKB-SË MBI MJEDISIN DHE ZHVILLIMIN (UNCED)²⁹, RIO DE JANEIRO

Ideja dhe koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm përhapen në të gjithë planetin. Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi social dhe ekonomik tani vendosen në të njëjtin nivel. Për herë të parë u kërkohej shteteve të përpunojnë strategji të bazuara në zhvillimin e qëndrueshëm. Vendet pjesëmarrëse nënshkruajnë tre marrveshje jo kufizuese në shkallë ndërkombëtare (*Axhenda 21, Deklarata e Rios, Deklaratë e principeve për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve*) dhe dy konventa kufizuese nga ana juridike (*Konventa kuadër mbi ndryshimet klimatike, Konventa mbi biodiversitetin*).

1994: KARTA E ALBO³⁰ (AALBORG)

Ky dokument është nënshkruar në Albo, Danimarkë (*Aalborg, Denmark*), nga pjesëmarrësit në Konferencën evropiane mbi qytetet dhe komunat e qëndrueshme. Ai konkretizon Axhendën 21 në shkallë lokale. Qytetet dhe komunat që kanë aderuar, zotohen të nisin procedurat lokale të Axhendës 21 dhe të zhvillojnë programe mbi veprimtari të qëndrueshme. Dhjetë vite më vonë, qytetet dhe komunat e përfshira nënshkruajnë **“Zotime”**³¹, që përforcojnë angazhimet për një vizion të përbashkët të zhvillimit të qëndrueshëm.

²⁷ Nga libri, *The Limits to Growth*

²⁸ WCED - World Commission on Environment and Development

²⁹ UNCED - United Nations Conference on Environment and Development

³⁰ The Aalborg Charter, Danimarkë

³¹ Commitments

1997: PROTOKOLLI KIOTO (KYOTO)

Protokolli i Kioto-s³² (*Kyoto*) është një traktat ndërkombëtar në fushën e mjedisit për sa i përket mbingrohjes globale i nënshkruar në qytetin japonez Kyoto me 11 dhjetor 1997 nga më shumë se 170 vende me rastin e **Konferencës COP3**³³ të **Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike (UNFCCC)**³⁴. Traktati hyri në zbatim më 16 shkurt 2005, mbas ratifikimit edhe nga ana e Rusisë.

Protokolli i Kioto-s detyron vendet e industrializuara dhe ato me ekonomi në tranzicion (*vëndet e Evropës lindore*), të përmbledhur në një listë përkatëse prej 38 vendesh (*Aneksi B i Protokollit të Kiotos*), të reduktojnë emetimin total të gazit serë në 5% brenda periudhës nga viti 2008 në 2012.

Gjithashtu, masat kombëtare të vendeve të **Aneksit B** të cilëve iu drejtohet Protokollin, mund të integrohen nga programe bashkëpunimi midis vendeve të zhvilluara dhe vendeve me ekonomi në tranzicion, duke i nxitur më tepër të bashkëpunojnë për t'i bërë efikase dhe efektive përpjekjet në zbatimin e masave dhe aksioneve të parashikuara nga Protokollin. Në veçanti, bashkëpunimi duhet të ketë të bëjë me shkëmbimin e eksperiencave, të informacioneve dhe të njohurive të marra nga aplikimi i politikave përkatëse dhe masave vepruese. Për zbatimin e Protokollit, llojet e bashkëpunimit në brendësi të vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim mund të zhvillohen nëpërmjet disa mënyrave të njohura si mekanizma elastike. Mekanizmat elastikë përfshijnë projekte mbi mbrojtjen e klimës në vende të tjera të zhvilluara **Implementim i Përbashkët (Ji)**³⁵, ose në vende në zhvillim **Mekanizmi i Zhvillimit të Pastër (Cdm)**³⁶, si edhe **Tregu Ndërkombëtar i të Drejtave të Emetimit (Iet)**³⁷. Me këto mekanizma, Protokollin Kioto i lejon çdo vendi të ulë emetimet me anë të projekteve të realizuara jashtë vendit.

Përtej çështjeve ende në diskutim, akordi i arritur në Kioto përfaqëson një ngjarje rëndësia e së cilës tejkalon vetë temën e akordit. Protokollin Kioto përfaqëson në fakt një përpjekje tejet origjinale për menaxhimin e zhvillimit të sistemit energjetik botëror duke e drejtuar atë drejt qëndrueshmërisë.

Pra, politikat dhe masat e menaxhimit të tranzicionit energjetik të parashikuara në Protokoll, theksojnë rëndësinë e një shfrytëzimi më efikas të energjisë në sektorët e industrisë, të transportit, të rezidencave dhe industrive të shërbimit, dhe insistojnë për përmirësimin e ofertës së energjisë duke i dhënë rëndësi në veçanti përhapjes më të gjerë të energjive të ripërtëritshme.

³² The Kyoto Protocol

³³ COP3 - Third session of the Conference of Parties to the UNFCCC më 1997 në Kyoto, Japoni, ku Protokollin Kyoto u miratua.

³⁴ UNFCCC - United Nations Framework Convention on Climate Change

³⁵ Ji - Joint implementation.

³⁶ Cdm - Clean development mechanism.

³⁷ Iet - International emissions trading

1997: KONFERENCA E OKB-SË + 5, NJU JORK (NEW YORK)

Që prej vitit 1992 nuk ka pasur progres. Padrejtësitë sociale, varfëria, emetimet e gazit serë, lëndët helmuese dhe sasia e mbeturinave të ngurta kanë vazhduar të rriten. Për këtë, për 5 vitet e ardhshme nënshkruhet një program pune për zbatimin e Axfordës 21 ku prezantohen strategjitë e para kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm, mes të cilëve edhe ai i Zvicrës.

2000: SYNIMET E OKB-SË PËR ZHVILLIMIN E MIJËVJEÇARIT

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së vendos tetë objektiva të matshëm për t'u plotësuar brenda vitit 2015: zhdukja e urisë dhe varfërisë ekstreme, arsim fillor i detyruar për të gjithë, mundësi të barabarta mes burrit dhe gruas dhe përforsim i rolit të gruas, reduktim i vdekshmërisë së fëmijëve, përmirësim i asistencës shëndetsore për nënat, luftë kundër HIV/AIDS, malarjes dhe sëmundjeve të tjera të rënda, siguri i qëndrueshmërisë mjedisore, zhvillim i një aleance globale për zhvillimin.

2001: STRATEGJIA EVROPIANE PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM

Këshilli i Bashkimit Evropian pohon qartë se rritja ekonomike dhe shfrytëzimi i burimeve duhet të veçohen nga njëri-tjetri. Strategjia rinovohet më 2006. Principet udhëzues të strategjisë 2006 janë: inkurajimi dhe mbrojtja e të drejtave themelore, drejtësia e brezave dhe ndërmjet brezave të ndryshëm, mbrojtja e një shoqërie të hapur dhe demokratike, përfshirja e popullsisë së ndërmarrjeve dhe partnerëve socialë, koherenca politike dhe integrimi, përdorimi i njohurive më të mira të mundshme, zbatimi i principeve të parandalimit dhe i principit “*kush ndot, paguan*”.

2001: VLERËSIMI I EKOSISTEMIT TË MIJËVJEÇARIT (MEA)³⁸

Një studim i gjerë i OKB-së i hedh një vështrim sistematik gjendjes së 24 ekosistemeve kryesore të pranishëm në tokë. Rezultatet e publikuara në vitin 2005 tregojnë se planeti ynë ndodhet në një gjendje shkatërrimi: 15 prej 25 ekosistemeve të ekzaminuar (60%) janë në një shkallë degradimi të përparuar.

2002: DEKLARATA E JOHANESBURG (JOHANNESBURG) MBI ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM³⁹ MIRATUAR NË SAMITIN BOTËROR PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM (WSSD)⁴⁰

Tematikat kryesore të samitit janë: drejtësia sociale, dialogu mes kulturave të ndryshme, shëndeti dhe zhvillimi. Pjesëmarrësit pohojnë zotimin e tyre në favor të Axfordës 21, të Deklaratës së Rios mbi mjedisin dhe zhvillimin dhe të objektivave të zhvillimit të mijëvjeçarit. Nënshkruhet një deklaratë me karakter politik, me detyra dhe propozime mbi zhvillimin e qëndrueshëm si dhe Plani i zbatimit të Johannesburg jo kufizues nga ana juridike. Gjithashtu, iniciativat për partneritet mes botës ekonomike, organizatave joqeveritare dhe shoqërisë civile duhet të ndihmojnë në arritjen e këtyre objektivave.

³⁸ MEA - Millennium Ecosystem Assessment

³⁹ The Johannesburg Declaration on Sustainable Development, Earth Summit 2002

⁴⁰ WSSD - World Summit on Sustainable Development

2005: SAMITI BOTËROR M + 5⁴¹ I OKB-SË, NJU JORK

Ekzaminimi i rezultateve të ndërmjetme të arritura nga shtetet nga pikëpamja e objektivave të mijëvjeçarit qartëson prioritetet e zhvillimit të qëndrueshëm. Mes detyrave kryesore dallohen: lufta kundër varferisë, paqja dhe siguria, respektimi i të drejtave të njeriut. Këto detyra kërkojnë një përforsim të qeverisjes globale, pra reforma institucionale brenda OKB-së.

2005: DEKLARATA E PARISIT MBI EFIKASITETIN E BASHKËPUNIT PËR ZHVILLIM⁴²

Me Deklaratën e Parisit, më tepër se 90 shtete zotohen të respektojnë kriteret e përbashkëta për të bashkëvepruar për një zhvillim efikas në fushat që vijnë: përgjegjësi nga ana e qeverive të vendeve përfituese për zhvillimin e tyre, harmonizim i praktikave të dhuruesve, përcaktim i synimeve të përbashkëta, paraqitje e rezultateve të matshme.

2005: DEKADA E EDUKIMIT PËR NJË ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM 2005 – 2014 E OKB-SË

Duke pasur parasysh rëndësinë e edukimit si themel i të vepruarit sipas zhvillimit të qëndrueshëm, OKB-ja aktivizon në shkallë globale **Dekadën e Edukimit për një Zhvillim të Qëndrueshëm për Edukimin, Kulturën dhe Komunikimin (UNESCO)**⁴³.

2011: STRATEGJIA E ORGANIZATËS PËR BASHKËPUNIM EKONOMIK DHE ZHVILLIM (OECD)⁴⁴ PËR NJË “ZHVILLIM TË GJELBËRT”

Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), shtjellon principin “*rritje e gjelbërt*”. Në kuadër të **Strategjisë për Rritjen e Gjelbërt (GGS)**⁴⁵, Këshilli i OECD-së shpall në nivel ministerial disa rekomandime për vendet pjesëmarrëse, që tregojnë se si duke përdorur instrumentat politikë të duhur mundësohet rritja ekonomike me anë të rritjes së efikasitetit të përdorimit të burimeve.

2011: RAPORTI I EKONOMISË SË GJELBËRT I UNEP

Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP)⁴⁶ frymëzohet që nga 2008 nga një princip i ngjashëm në kuadër të **Iniciativës për një Ekonomi të Gjelbërt**⁴⁷. Kjo nismë inkurajon investimet publike dhe private të cilat përdorin metoda prodhuese që respektojnë më shumë mjedisin.

2012: KONFERENCA E OKB-SË MBI ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM (“RIO+ 20”)

Njëzet vjet mbas Konferencës së OKB-së të vitit 1992 mbi mjedisin dhe zhvillimin, mbahet në Rio de Janeiro (*Rio de Janeiro*) Konferenca e OKB-së mbi zhvillimin e qëndrueshëm.

⁴¹ World Summit (Millennium Summit+5), 2005

⁴² Déclaration de Paris sur l’efficacité de l’aide au développement, 2005

⁴³ UNESCO - The United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization

⁴⁴ OECD - Organisation for Economic Cooperation and Development

⁴⁵ GGS - Green Growth Strategy

⁴⁶ UNEP - United Nations Environment Programme

⁴⁷ Green Economy Initiative

Synimi i samitit është ripërtëritja e zotimit politik në favor të zhvillimit të qëndrueshëm. Në të skicohet një bilanc mbi zbatimin e udhëzimeve mbi zhvillimin e qëndrueshëm dhe ilustrohen perspektivat për të ardhmen.

Konferenca rrotullohet rreth dy tematikave qendrore:

- Zotimi i politikës botërore në favor të zhvillimit të qëndrueshëm, duke vendosur në plan të parë zhvillimin e **”ekonomisë së gjelbërt”** në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm dhe luftën kundër varfërisë si dhe kushtet institucionale për një zhvillim të qëndrueshëm.
- **Edukimi për një Zhvillim të Qëndrueshëm (ESD)⁴⁸**. Bëhet fjalë për integrimin e konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm në të gjithë nivelet e sistemit edukativ, duke vendosur kështu bazat për një shoqëri të qëndrueshme.

2015: KONFERENCA E OKB-SË MBI ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM NË PARIS

Që nga 30 Nëntori deri më 12 Dhjetor 2015, në Paris u zhvillua seksioni i 21-të i Konferencës së Palëve (COP 21) të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimaterike (UNFCCC) dhe seksioni i 11-të i Takimit të Palëve të Protokollit Kioto (CMP 11).

Elementet kryesore të marrëveshjes të Parisit:

- **objektiv afatgjatë:** qeveritë anëtare ranë dakord në mbajtjen e rritjes së temperaturës mesatare globale deri me 2 gradë poshtë në krahasim me nivelet preindustriale dhe në vazhdimin e përpjekjeve për t’a limituar në 1,5 gradë.
- **kontribute:** përpara dhe gjatë konference së Parisit, vendet e ndryshme prezantuan plane veprimi kombëtare globale në fushën e klimës që kanë për qëllim uljen e emetimeve përkatëse.
- **synimet:** qeveritë vendosën të bëjnë publike çdo 5 vjet kontributet e veta për të caktuar objektiva më ambicioze.
- **transparenca:** palët pranuan gjithashtu t’i bëjnë publike njëri-tjetrit dhe publikut rezultatet e arritura në zbatimin e objektivave përkatës me qëllim garantimin e transparencës dhe kontrollit.
- **solidaritet:** Bashkimi Evropian dhe vendet e tjera të zhvilluara do të vazhdojnë të financojnë për klimën vendet në zhvillim për t’i ndihmuar ata në reduktimin e emetimeve, si dhe të bëhen më elastikë ndaj efekteve të ndryshimeve klimaterike.


⁴⁸ ESD - Education for Sustainable Development

2.4 Burimet energjetike të ripërtëritshme

Energji të ripërtëritshme janë ato lloje energjish të gjeneruara nga burime “të pashtershme” (dielli, era, burimet hidrike, burimet gjeotermike, baticat - zbaticat, valët dhe transformimi i produkteve vegjetale ose i mbeturinave organike dhe joorganike në energji elektrike ose termike). Energji të papërtëritshme janë kryesisht burimet fosile si petroli, karboni, gazi natyror.

Interesi për energjitë e ripërtëritshme ka dalë në pah në vitet '70, mbas krizës së madhe botërore të petrolit në 1973. Në 1974 u publikua relacioni “**Momenti për të Zgjedhur**” (A Time to Choose) i **David Friman** (David Freeman) i porositur nga **Fondacioni Ford**, që drejtonte vëmendjen tek mundësitë që jep përdorimi i energjive të ripërtëritshme dhe te kursimet energjetike falë teknologjive të reja prodhuese. Ende nuk flitej për ndryshime klimaterike. Çështjet kryesore ishin të lidhura me ndotjen atmosferike dhe me kapërcimin e rreziqeve ekonomike dhe politike të shkaktuara nga varësia ndaj importimeve të energjisë. Krerët politikë kombëtarë amerikanë mbështesnin dhe inkurajonin prodhimin dhe përdorimin e të ashtuquajturave “**energji të gjelbërta**”.

Provat shkencore tani po rikonfirmohen: ndryshimet klimaterike paraqesin rreziqe shumë serioze globale, të cilat kërkojnë një përgjigje globale të menjëhershme⁴⁹ (grafiku 4).



Grafiku 4: Ndryshimet Klimaterike – një fakt i pamohueshëm

Në të njëjtin vit të firmosjes së Protokollit Kioto, Komisioni Evropian publikoi Librin e Bardhë “**Energji për të ardhmen - burimet energjetike të ripërtëritshme**” ku vendoset synimi për arritjen në Bashkimin Evropian brenda 2010 të rritjes me 12% të përdorimit të energjisë së ripërtëritshme.

⁴⁹ NASA Ndryshimet e Temperaturës Globale

Në shtator 2001 u miratua “**Direktiva 2001/77/CE e Parlamentit Evropian**” qëllimi i së cilës është “*promovimi i një kontributi më të madh të burimeve energjetike të ripërtëritshme në prodhimin e energjisë elektrike në tregun e brendshëm përkatës dhe krijimi i themeleve për një kuadër të ardhshëm të përbashkët në këtë fushë*”.

Në vitet në vijim, Komisioni ndoqi një “**Plan veprimi për efikasitetin energjetik: konkretizimi i mundësive**”- COM (2006), qëllimi i të cilit është “*përmbajtja dhe reduktimi i kërkesës energjetike, dhe pse jo, veprimi në mënyrë specifike mbi konsumin dhe furnizimin për të arritur reduktimin prej 20% të konsumit vjetor të energjisë primare brenda 2020 (në krahasim me parashikimet për konsumin energjetik 2020)*”.

Synimet janë:

1. **Reduktimi prej 20% i emetimeve të CO₂ (dioksidi i karbonit)**
2. **Rritja e efikasitetit prej 20% në fushën energjetike**
3. **Rritja e Prodhimit të energjisë së ripërtëritshme me 20% brenda vitit 2020**


Me miratimin e “**Strategjisë 20-20-20**”, Evropa propozohet si kryesubjekt në zhvillimin e energjive të ripërtëritshme, në luftën kundër ndryshimit klimaterik, dhe nëse do të jetë e aftë të transformojë zotimet e marra në politika dhe në veprime konkrete, mund të luajë rolin e leadership-it në veprimtarinë globale për realizimin e një shoqërie me emetim të ulët karboni.

Në Gjermani, aktualisht, më shumë se 10% e energjisë së prodhuar në vend vjen nga burime energjetike të ripërtëritshme. Kjo përqindje është e destinuar të rritet falë **Ligjit mbi Energjitë e Ripërtëritshme (EEG)**⁵⁰.

Në Shtetet e Bashkuara, në fillim të 2009, stafi i Presidentit Barak Obama vendosi në bilanc 54 miliardë dollarë me qëllim një vend më të gjelbërt dhe më pak të varur nga petroli.

Harta e fuqisë së energjisë diellore tregon potencialin rajonal për prodhim të energjisë elektrike me anë të paneleve diellore. Këto të dhëna janë llogaritur dhe prezantuar nga banka e të dhënave **Sanbërd (Sunbird) e Qendrës së Kërkimeve**. Të dhënat i referohen rendimentit total vjetor të prodhimit të energjisë elektrike diellore të vlerësuar (*për planet horizontale, vertikale, të pjerrët në mënyrë optimale,*) [kWh] (figura 6).


⁵⁰ EEG - Erneuerbare Energien Gesetz



EUROPEAN UNION
Part-financed by the European Regional Development Fund
INVESTING IN YOUR FUTURE


Regional level: NUTS 2
Source: ESPON 2013 Database, 2010
Origin of data: JRC, Sunbird Database
© EuroGeographics Association for administrative boundaries

Solar energy output



Due to the reliability and quality of the datasets behind this map, the Lead Partner of the ReRisk Project decided not to include data collected from other sources than JRC


Figura 6: Harta e Prodhimit të energjisë së përfutur nga energjia diellore



EUROPEAN UNION
Part-financed by the European Regional Development Fund
INVESTING IN YOUR FUTURE

Regional level: NUTS 2
Source: ESPON 2013 Database, 2010
Origin of data: EEA, 2009
© EuroGeographics Association for administrative boundaries

Wind power potential in 2005




Due to the reliability and quality of the datasets behind this map, the Lead Partner of the ReRisk Project decided not to include data collected from other sources than EEA


Figura 7: Harta e Potencialit të Energjisë së Erës, 2005

Të dhënat origjinale mbi intensitetin e erës së zonave janë përgatitur në format GIS⁵¹ nga **Qendra Tematike Evropiane Ajri dhe Ndryshimet Klimaterike (ETC / ACC)**, e drejtuar nga **PBL** Vendet e Ulëta, me kërkesë të **SEE (EEA, 2009)**. Intensiteti i erës është konvertuar në nivel **NUTS 2** nga **ESPON**. Ai mat fuqinë e prodhimit të centraleve të erës duke pasur parasysh mjedisin dhe limite të tjera. Zonat me potencial më të lartë janë të indikuara me tonalitet më të errët; Suedia, Finlanda, Irlanda, Estonia, Lituania si dhe veriu i Norvegjisë dhe Skocisë. Por, shumica e këtyre zonave ndodhen tepër larg nga tregjet urbane kryesore ku përqëndrohet kërkesa për energji elektrike (figura 7).

Grafikët e mëposhtëm tregojnë përqindjet e burimeve energjetike të ripërtëritshme kundrejt atyre të papërtëritshme në BE dhe në Shqipëri (grafikët 5,6).




Grafiku 5: Burimet energjetike të ripërtëritshme kundrejt atyre të papërtëritshme në BE



Grafiku 6: Burimet energjetike të ripërtëritshme kundrejt atyre të papërtëritshme në Shqipëri

⁵¹ Geographic Information System

Nga një kërkim i **“Institutit Worldwatch”**, që ka analizuar skenarët e zhvillimit të qëndrueshëm botëror të sektorit energjetik, del në pah se në ditët e sotme janë mbi të gjitha **“Vendet në zhvillim”** ata që nxisin konkretisht projektet e bazuar në energjinë nga burime të ripërtëritshme⁵² (grafiku 7).




Grafiku 7: Investimetet e reja Globale në Energjitë e Ripërtëritshme sipas rajoneve, 2004 – 2013

Shumë vende në zhvillim e kanë kuptuar rëndësinë e zgjedhjeve të tilla strategjike, pasi duke u përqëndruar tek burimet e ripërtëritshme mund të arrijnë të parandalojnë ndotjen dhe

⁵² <http://www.powerclouds.com/index>

në të njëjtën kohë të zhvillojnë dhe rrisin ekonominë vendase duke lehtësuar edhe hyrjen e kapitaleve të huaja.

Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë së Ripërtëritshme (IRENA)⁵³: Grafiku i mëposhtëm tregon ndarjen e konsumit energjetik nga burime të ripërtëritshme në shkallë botërore në 2010 dhe atë të Remap2030 (grafiku 8,9).



Grafiku 8, 9: Energjia e ripërtëritshme globale e përdorur nga teknologjitë dhe sektorët, 2010 dhe në REmap 2030

Adnan Z. Amin (Drejtor i përgjithshëm i IRENA). “Çështja politike qendrore është: Tek cilat burime energjetike duam të investojmë? Të dhënat tona tregojnë se energjia e

⁵³ IRENA - International Renewable Energy Agency

ripërtëritshme mund të kontribuojë në shmangien e ndryshimeve klimaterike katastrofike dhe në kursimin e parave të mbarë botës, nëse mbahen parasysh të gjitha kostot⁵⁴”. **REmap 2030** ka treguar se tranzicioni është i mundur tashmë me teknologjitë ekzistuese dhe se përfitimet tejkalojnë ndikimin mjedisor pozitiv.

2.5 Çertifikimi energjetik; mjetet, normat dhe nismat e ndërmarra në këtë fushë

Ndërtimi është një nga sektorët më ndotës të mjedisit. Ky sektor, në fakt, konsumon lëndë të parë më shumë se çdo sektor tjetër industrial, rreth 50%. Gjithashtu, mjedisi i ndërtuar prodhon 40% të emetimit të gazit serë prej konsumit të energjisë dhe përdorimit të ndërtesës gjatë ciklit jetësor të saj. Dëmet mbi mjedisin rriten për shkak të përdorimit të energjisë gjatë ndërtimit të një objekti, për ngrohjen e tij, kondicionimin, ndriçimin, dhe për shkak të përbërësve kimikë të materialeve të përdorur për ndërtim. E gjithë kjo çon industrinë ndërtimore të ketë nevojë për një ndryshim në mënyrë që të arrijë një qëndrueshmëri afatgjatë. Për një zhvillim të qëndrueshëm është e rëndësishme që ndërmarrjet të sillen me përgjegjësi (**CG, CSR**)⁵⁵ (*përgjegjësi sociale, mjedisore*). Nga një pikëpamje më e gjerë, është gjithashtu e rëndësishme që një ndërmarrje të zhvillojë marrëdhënie të barabarta dhe transparente me pjesëmarrës të tjerë të interesuar “**stakeholder**”: punonjës, ente publike, institute kredish, klientë dhe furnizues. **Organizata Ndërkombëtare për Standardizimin (ISO)**⁵⁶, ka përpunuar një normë për përgjegjësitë sociale të ndërmarrjeve (ISO 26000). Norma ISO 14001, kriteret ndërkombëtare për zbatimin e sistemeve të menaxhimit të mejdisit. Ndërmarrjet që respektojnë këto kriterë dhe që përfitojnë çertifikatën përkatëse tregojnë që në proceset e tyre kanë pasur respekt ndaj mjedisit. Në këtë mënyrë, ndërmarrja fiton besimin e klientëve, furnizuesve, bashkëpunuesve, autoriteteve, investitorëve dhe e shoqërisë në përgjithësi. **Eko-Menaxhimi dhe Skema e Auditimit (EMAS)** është një variant më i përhapur i Bashkimit Evropian. Edhe në këtë rast, objektivi është që t’i lejojë ndërmarrjeve të vlerësojnë, komunikojnë dhe përmirësojnë progresin në fushën mjedisore. Sistemet vlerësuese me pikë mes të cilëve **Sfidat për Ndërtesat e Gjelbërta (GBC)**⁵⁷ i caktojnë ndërtesës pikë sipas performancës së saj në krahasim me një sërë referimesh të vlerësimit të ndikimit mbi mjedisin: vlerësimi me pikë lejon klasifikimin e ndërtesës në lidhje me një shkallë cilësie. Në këtë mënyrë, “**klasa**” e ndërtesës mund të dallohet lehtësisht edhe nga përdoruesi.

Në Evropë po rritet fatmirësisht interesi për prodhimin e materialeve ku procesi i nxjerrjes, transportit, përpunimit dhe riciklimit final ndjek metodologjinë **Vlerësimi i Ciklit të Jetësor (LCA)**⁵⁸. Nga sistemi i analizës dhe i vlerësimit të ciklit jetësor të çdo materiali të prodhuar mund të kalohet në një vizion më të gjerë që merr në konsideratë ndërtesën në tërësinë e saj. Në këtë rast mund të flitet për metoda vlerësuese me pikë.

⁵⁴ http://www.irena.org/REmap/REmap_Report_June_2014.pdf... **Adnan Z. Amin**, drejtor i përgjithshëm i IRENA.

⁵⁵ CG, CSR - Corporate Governance, Corporate Social Responsibility

⁵⁶ ISO - International Organization for Standardization

⁵⁷ GBC - Green Building Challenge

⁵⁸ LCA - Life Cycle Assessment

Gjatë dy dekadave të fundit **Shoqata Evropiane e Prodhuesve të Izolimit (EURIMA)**⁵⁹ ka studiuar zhvillimin e standarteve të izolimit termik në ndërtesa të reja evropiane. Një studim i hollësishëm i kohëve të fundit ka treguar një progres të vazhdueshëm për sa i përket standarteve të izolimit në Zvicër e ndjekur nga vendet skandinave, duke i treguar kështu pjesës tjetër të Evropës rrugën për t'u ndjekur.

Si përfundim mund të themi se izolimi i ndërtesave:

- redukton në mënyrë drastike shpenzimet e nevojshme për ngrohjen dhe freskimin e ndërtesave.
- redukton në mënyrë drastike emetimin e gazeve serë.
- përmirëson komfortin në brendësi të ndërtesave duke mbrojtur kështu shëndetin tonë
- më pak varësi nga lëndët djegëse fosile sepse sa më i lartë është izolimi termik aq më shumë mund të përdoren burimet e energjisë së ripërtëritshme dhe falas të pranishme në mjedis (*energji diellor, e erës, gjeotermike.....*).

Dekreti legjislativ **Nr. 192** në fakt, parashikon që çdo banesë në një të ardhme të afërt do t'i nënshtrohet certifikimit energjetik duke përdorur një procedurë të përbashkët në nivel evropian, "**Certifikata Energjetike**" që do të përmbajë konsumet energjetike të apartamentit dhe që do t'u bashkangjitet kontratave të shitblerjeve. Gjithashtu, dekreti detyron përdorimin e një spessori minimal izolimi termik, i cili mund të llogaritet në bazë të tabelave referuese që përcaktojnë vlerat minimale të tejçueshmërisë termike që duhen respektuar; këto vlera ndryshojnë sipas zonës klimatike ku objekti do të ndërtohet.

Sipas analizimit të ndërtesave në tërësinë e tyre, shumë rajone kanë ndërmarrë programe për të nxitur një projektim më të ndërgjegjshëm:

- lehtësime financiare dhe reduktim të taksave (*reduktimi i detyrimeve të urbanizimit*).
- kontribute financiare për realizimin e ndërtesave të reja të karakterizuara nga konsum energjetik modest dhe nga ndikimi i ulët mbi mjedisin.
- sistem certifikimi në shkallë kombëtare.
- mjete përkrahëse.

Pra, në shkallë evropiane ka një interes të dyanshëm: nga një anë është ligjvënësi për emetimin e normave dhe ligjeve për një qasje të qëndrueshme në ndërtim (*për shembull Direktiva 106/89 mbi "Kushtet thelbësore për produktet e ndërtimit" ose rregullorja e komunitetit 880/92 mbi Ecolabel*), direktiva **2010/31/BE** dhe **2012/27/BE** për **Ndërtim me Energji Pothuajse Zero (NEZB)**⁶⁰, mbi performancën energjetike të ndërtesave, dhe nga ana tjetër kërkimet shkencore të përqëndruara në llogaritjen e kushteve energjetike dhe në emetimet lidhur me ciklin jetësor të produkteve.

⁵⁹ EURIMA - European Insulation Manufacturers Association

⁶⁰ NEZB - Nearly Energy Zero Building

Kapitulli III

METODOLOGJIA E VLERËSIMIT DHE MONITORIMIT NË LAGJET E QËNDRUESHME

Përse lagje të qëndrueshme?

Lagjja shërben si laborator eksperimental dhe ofron mundësi ndërhyrjeje, pasi përfaqëson një pjesë realiteti urban me përmasa të gjëra. Lagjet kanë një rëndësi të veçantë në menaxhimin e hapësirave publike, në realizimin e ndërtesave ekologjike dhe në promovimin e integritimit social ndërmjet brezave të ndryshëm, pra përfaqësojnë mjedisin ideal për zbatimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

3.1 Kriteret dhe Strategjitë e Vlerësimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm

Me fillimin e shekullit të XXI-të, janë të shumtë shtetet të cilët kanë ndërmarrë masa për studimin e kriterëve vlerësues dhe strategjive të avancuara për monitorimin e qëndrueshmërisë në realizimin e eko-lagjeve. Një nga shtetet me rezultate më të larta dhe më konkrete në këtë fushë ngelet Zvicra, e cila është shprehur në favor të zhvillimit të qëndrueshëm në shkallët më të larta të politikës; qysh prej 1999 në **Kushtetutën Federale** është shtuar një artikull i ri i dedikuar zhvillimit të qëndrueshëm (*“të veprojë në favor të një mardhënieje afatgjatë të ekuilibruar mes natyrës, aftësive të saj për rinovim dhe përdorimit të saj nga njeriu”*).

Më pas, Konfederata, për të konkretizuar konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm, ka ndërmarrë përpjekje të ndryshme ndër të cilat përmendim në veçanti:

- “**Strategjia e Këshillit Federal për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2002**”
- “**Monitorimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm**” të Zyrtarëve Federale të Statistikës (BFS)⁶¹, të Mjedisit, të Pyjeve, të Peizazhit dhe të Zhvillimit Territorial (ARE)⁶².
- Projekti “**Vlerësimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Bazat Metodologjike për Zhvillimin Territorial 2004**”.

Të gjitha punimet e drejtuara nga principet e zhvillimit të qëndrueshëm bazohen në nocionin e përcaktuar nga **Komisioni Brundtland** dhe të formuluar te “**Deklarata e Rios mbi Mjedisin dhe Zhvillimin**” të **Kombeve të Bashkuara** në vitin 1992⁶³. Koncepti i përkufizuar në Deklaratën e Rios mbështetet në dy kollona: *barazia mes brezave të ndryshëm dhe në të njëjtin brez dhe pse jo ekuivalenca mes qëllimeve sociale, ekonomike dhe mjedisore*. Kjo do të thotë që nevojat e të gjitha qenieve njerëzore duhet të plotësohen sot dhe në të ardhmen. Njëkohësisht, duhen ruajtur për një kohë sa më të gjatë kushte jetese të sigurta dhe të denja për të gjithë. Kjo pikë kryesore e dytë, quhet edhe “**koncepti i tre përmasave**” (figura 8), sepse burimet ekzistuese në Tokë janë të ndara në një përmasë sociale, ekonomike dhe mjedisore.

⁶¹ BFS - Bundesamt für Statistik, Switzerland

⁶² ARE - Bundesamts für Raumentwicklung, Switzerland

⁶³ UNCED: United Nations Conference on Environment and Development, Rio de Janeiro, 1992

Dy kollona: “*barazi dhe ekuivalencë e tre përmasave*”.




Figura 8: Kryqëzimi i dy shtyllave - koncepti i tre përmasave

Zhvillimi i qëndrueshëm pasqyrohet shpesh me tre rrathë që përcaktojnë tre përmasat referuese (*mjedisin, ekonominë dhe shoqërinë*), të shpërndara përgjatë boshtit kohor (*lindje-perëndim*) dhe atij hapësinor (*veri-jug*).

Ky përfaqësim duhet kuptuar si vijon:

- **Vizion i përgjithshëm i ekonomisë, shoqërisë dhe mjedisit**

Proceset ekonomike, sociale dhe mjedisore janë të lidhura ngushtë mes tyre dhe ndikojnë njëra-tjetrën. Ndërhyrja e aktorëve publikë dhe privatë nuk duhet të jetë e izoluar apo sektoriale, por duhet të mbajë parasysh ndërveprimet mes këtyre tre dimensioneve (*mjedisi, ekonomia, shoqëria*).

- **Solidaritet me brezat e ardhshëm**

Shfrytëzimi i ekzagjeruar i burimeve dhe hapësirës jetësore si dhe borxhi, limitojnë zhvillimin e brezave të ardhshëm. Zhvillimi është i qëndrueshëm vetëm atëherë kur merr parasysh nevojat e brezave të ardhshëm (*solidaritet ndërbrezor*) dhe nuk i dëmton ata.

- **Solidaritet në brendësi të brezave aktualë**

Një zhvillim afatgjatë dhe i qëndrueshëm i planetit është i mundur vetëm nëse të gjithë njerëzit kanë të drejta të barabarta përsa i përket shfrytëzimit të burimeve të disponueshme (*solidaritet brezor*).

3.2 Filozofia dhe zbatimi i metodologjisë “Zmeo” (Sméo) në realizimin e eko-lagjeve

Shpërhapja territoriale e vendbanimeve shpesh karakterizohet nga një menaxhim kaotik, riprodhon shumë probleme mjedisore, social-kulturore dhe ekonomike. Përdorimi i paarsyeshëm i terrenit çon në rradhë të parë në një konsum të burimeve të papërtëritshme dhe nga ana tjetër ushtron presion të dëmshëm mbi peizazhin. Diferencimi funksional i territorit është gjithashtu i përgjegjshëm për një degradim të rëndë të mjedisit për shkak të distancave më të mëdha për t'u përshkuar dhe rritjes së lartë të transportit privat. Fenomeni i shpërhapjes mes zonave të banuara, punës, zonave tregtare dhe zbavitëse detyron një pjesë të mirë të popullsisë të varet fortësisht nga automjetet vetjake, me rrjedhoja të theksuara mbi konsumin energjetik, me probleme mbingarkese të trafikut, ndotje akustike dhe atmosferike⁶⁴. Zgjerimi i sipërfaqes urbane provokon në të njëjtën kohë një impakt më të madh mjedisor për shkak të ndërtimit dhe shfrytëzimit të rrjeteve infrastrukturore (*përplasje ndërmjet infrastrukturës me rrjetet hidrike, elektrike, mes kanalizimeve, etj.*) dhe rrjedhoja negative nga ana ekonomike⁶⁵. Kostot e ndërlidhjeve të ndërtimeve të reja në rast rritjeje të dendësisë së popullsisë rezultojnë në fakt shumë herë më të ulta në krahasim me kostot në rast shpërhapje të sipërfaqes së vendbanimeve në zona periferike. Studimi arrin në konkluzionin “*nëqoftëse prirja aktuale për shpërhapje të ndërtimeve në territor vazhdon do të veshitësohet gjithmonë e më shumë financimi i zhvillimit të infrastrukturave*”, ndërsa “*mundësitë për të përmbajtur kostot janë domethënëse në rast të një zhvillimi centripet të vendbanimeve të përqëndruara në zonat e ndërtuara ekzistuese*”.

Disa zona periferike, megjithë përpjekjet për një zgjerim dhe restaurim të rrjeteve të transportit dhe të shpërndarjes, rezultojnë më pak të pajisura me shërbime se zona të tjera duke shkaktuar “*izolim social*”. Nga pikëpamja social-kulturore, shpërhapja urbane paraqitet si një strukturë tërësisht delikate, në kundërshtim me vizionin e ekuilibrit afatgjatë. Në kushtet e një rritjeje demografike, shpërhapja urbane shkakton dallime të forta sociale dhe kosto më të larta menaxhimi⁶⁶.

Për të përballuar këto dinamika, politikat publike të pjesës më të madhe të vendeve evropiane, promovojnë prej më shumë se një dekade strategji territoriale të bazuara në procesin e dendësimit urban të sintetizuar nga formula sot shumë të përhapura të “*urbanizimit centripet*” ose “*ndërtimi i qytetit brenda qytetit*”. Pa një përdorim të arsyeshëm të terrenit, është i pamundur influencimi mbi tendencat e mëparshme.

Për këtë qëllim, është parësor rigjallërimi i lagjeve ekzistuese (*veçanërisht hapësirat në degradim*) dhe rivlerësimi i burimeve të pashfrytëzuara në mënyrë të mjaftueshme në zemër të zonave tashmë të urbanizuara (*zona industriale të braktisura, hapësira boshe të kufizuara nga objekte të tjera, shtesa të godinave ekzistuese*). Realizimi i këtyre objektivave për rritjen

⁶⁴ Fouchier, 1997; Newman & Kenworthy, 1999

⁶⁵ ARE, 2000

⁶⁶ Sauvez 2001

e dendësisë privilegjon projektet që zbatohen në qytetet dhe qendrat e banuara ekzistuese në krahasim me ato që tentojnë shpërhapjen.

Në këtë perspektivë, disa vende evropiane kanë stabilizuar limite sasiore ku Zvicra bën pjesë në ato që kanë përcaktuar si objektiv strategjik stabilizimin e sipërfaqes së urbanizimit në 400 m² për banor⁶⁷. Rritja e dendësisë përbën nyjen kryesore dhe një prej kushteve të domosdoshme për ruajtjen dhe rritjen e cilësisë së vendit.

Këto qëllime, janë pjesë përbërëse e “**Strategjisë për një Zhvillim të Qëndrueshëm**” e përvetësuar nga **Këshilli Federal**, që shpreh kërkesën për një përdorim të arsyeshëm të terrenit duke favorizuar së pari rritjen e dendësisë në zonat urbane⁶⁸. **Projekti Territorial Zvicra** përputhet plotësisht me këtë vizion, duke pohuar haptazi se nevoja për territor duhet të përqëndrohet në të ardhmen në zonat tashmë të edificuara, mbi të gjitha për sa i përket zhvillimit urban⁶⁹.

Rëndësia për të orientuar urbanizimin drejt brendësisë nuk është vetëm sasiore, por është pjesë e një procesi rivlerësimi të mënyrës së jetës qytetare dhe krijimit të një mjedisi të dendur dhe të qëndrueshëm në vend të një shtëpie monofamilare në periferi. Për këtë kërkim cilësor, lagjja ofron një “*laborator eksperimental*” dhe mundësi të shumta ndërhyrjeje pasi përfaqëson një pjesë të realitetit urban me përmasa të mjaftueshme ku mund të aplikohen kriteret e qëndrueshmërisë dhe të ndërmerren masa konkrete. Pra, lagjet luajnë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e hapësirave publike, në realizimin e ndërtesave ekologjike të pavarura energjikisht, në promovimin e integritit social dhe të brezave të ndryshëm, ose në menaxhimin e trafikut, duke u paraqitur kështu si hapësirë e privilegjuar për aplikimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Në pjesën më të madhe të qendrave të banuara ekzistojnë zona strategjike të ndjeshme ndaj evoluimit, pra drejt integritit të kriterëve mjedisorë, sociale-kulturore dhe ekonomike. Kalimi në statusin “*eko-lagje të qëndrueshme*” mund të përballet me disa ndërhyrje urbane në territore ende të pa edificuara, si nëpërmjet ringjalljes së hapësirave të braktisura industriale, ashtu dhe me ripërtëritjen e lagjeve ekzistuese. Edhe pse mënyrat vepruese të këtyre projekteve mund të jenë të ndryshme, ato i bashkon shumëllojshmëria dhe kompleksiteti i sfidës. Projekti i një lagjeje të qëndrueshme duhet nënkuptuar si një proces dinamik, që përfshin shumë subjekte dhe synon një kërkim të përbashkët zgjidhjesh për të shndërruar çdo veprim në çelësin e qëndrueshmërisë⁷⁰. Çdo përmirësim i projektit është pjesë e një procesi të vazhdueshëm perfeksionimi.

⁶⁷ Këshilli Federal 2002

⁶⁸ Këshilli Federal, 2008.

⁶⁹ DATEC, ARE, CdC, DCPA, UCS & ACS, 2011

⁷⁰ Wyss dhe al, 2010.

Si mund të garantohet përfshirja e të gjithë subjekteve kyçe që në fillim të këtij procesi angazhues, në mënyrë që projekti të përparojë ashtu siç duam?

Për këtë është e domosdoshme njohja në mënyrë të thellë e gjendjes fillestare, vendosja e synimeve të përbashkëta mes palëve të përfshira, vlerësimi i tyre në mënyrë të vazhdueshme gjatë veprimtarisë dhe vlerësimi i rezultateve të arritura për të nxjerrë konkluzione dhe për t'i konkretizuar duke ndërhyrë në mënyrat vepruese ose në vetë projektin.

Deri më sot, janë të shumta entet publikë, partnerët privatë dhe përfaqësuesit e shoqatave të cilët angazhohen në favor të zhvillimit të qëndrueshëm duke përfshirë në aktivitetet e tyre projekte dhe programe, aspekte të karakterit mjedisor, social dhe ekonomik. Megjithatë, nocioni i eko-lagjes së qëndrueshme përfaqëson një pikë mbërritjeje akoma pak të njohur, pasi deri më sot, janë të pakta metodologjitë ekzistuese të vlerësimit që do të na lejonin të strukturonim në mënyrë të qartë të metat.

Pikërisht në këtë kontekst, në vitin 2009, **Zyrat Federale të Energjisë (UFE)** dhe ajo e **Zhvillimit Territorial (ARE)** kanë lançuar projektin kombëtar **“Lagje të Qëndrueshme”** që ka për qëllim kryesisht zhvillimin e një metodologjie në mbështetje të procesit vendimtar dhe në vlerësimin e projekteve të lagjeve të qëndrueshme. Vlerësimi i kriterit të qëndrueshëm në nivel lagjeje kontribuon në mënyrë të rëndësishme në realizimin e objektivit të qëndrueshmërisë dhe në konkretizimin e tij sipas *Strategjisë për Zhvillimin e Qëndrueshëm*.

Metodologjia e quajtur **“Lagje të Qëndrueshme Zmeo”** është në dispozicion të bashkive dhe grupeve të tjera të interesit të zotuar në këtë lloj aktiviteti. Ajo përfaqëson një tabelë vlerësimi për fazat e ndryshme të projektit, dhe është rezultati i një faze të rëndësishme eksperimentimi që është treguar efikas në shumë projekte që janë në realizim e sipër.

Duke u nisur nga rëndësia e lagjeve të qëndrueshme në perspektivën e zhvillimit të përgjithshëm të mjedisit urban, ky studim do të përqendrohet në mënyrat e vlerësimit të qëndrueshmërisë dhe i drejtohet të gjithë atyre që janë të interesuar të vlerësojnë qëndrueshmërinë në nivel lagjeje, pavarësisht rolit të tyre politik, administrativ, akademik, të asociuar apo privat. Ky kontribut ka për qëllim analizimin e zhvillimit aktual të konceptit **“Lagje të Qëndrueshme”** nëpërmjet Metodologjisë **“Zmeo”** duke nënvizuar nevojën për të marrë parasysh përtej sloganëve kompleksitetin e këtyre lloj ndërhyrjesh dhe për t'i vlerësuar në mënyrë të strukturuar me qëllim që të dalin në pah praktikatat e virtytshme në fjalë.

Nocioni i lagjes së qëndrueshme

Duke marrë parasysh kompleksitetin e ndërveprimeve që karakterizojnë mjedisin e ndërtuar, duhet nënvizuar që një ndërhyrje e limituar vetëm ndaj rritjes së dendësisë, do të rezultonte tepër e thjeshtë dhe sigurisht e pamjaftueshme. Çështja e qëndrueshmërisë së mjedisit urban prej kohësh nuk është e limituar nga kriteret e lokalizimit të ndërtesave dhe nga rritja e dendësisë urbane. Me një fjalë, densiteti duhet konsideruar si një kusht i nevojshëm por jo i mjaftueshëm për qëndrueshmërinë. Nga pikëpamja e cilësisë globale të hapësirës jetësore, promovimi i këtij kthimi në qytet ngre shumë çështje në nivelin e projektit urbanistik dhe arkitektonik. Përveç aspekteve sasore, për të realizuar një rritje të cilësisë, është në fakt i domosdoshëm mundësimi i ndërhyrjeve të njëkohshme dhe konvergjente.

Lagjja e vendosur ndërmjet qytetit dhe ndërtesës, ofron nga kjo pikëpamje mundësi ndërhyrjeje interesante sepse lejon eksperimentimin e ndërhyrjeve specifike të qëndrueshmërisë në mjedisin urban. Në fakt, bëhet e mundur një qasje ndaj problematikave urbane që tejkalojnë dimensionin e ndërtesës si njësi e vetme. Synime konkrete për t'u realizuar janë: nevoja për të ndërhyrë në mënyrë të koordinuar mbi urbanizimin e lëvizshmërisë, për të krijuar pole mikse dhe kompakte dhe për të garantuar një cilësi jetese më të lartë të mjedisit urban.

Në këtë kontekst është zhvilluar nocioni i eko-lagjes së qëndrueshme që propozon realizimin e poleve urbane të dendura dhe mikse, cilësia e përgjithshme e së cilave i përgjigjet një vizioni global të qëndrueshmërisë. Edhe pse çdo fushë ndërhyrjeje është e karakterizuar nga kriteret specifike, është i mundur identifikimi i një sërë parametrash thelbësorë:

- **Dendësi, përzierje funksionale dhe lëvizshmëri e qëndrueshme.**

Krijimi i një lagjeje të qëndrueshme duhet të ketë parasysh planifikimin e koordinuar të urbanizimit dhe lëvizshmërisë: një lagje e dendur dhe mikse nga ana funksionale, ku aksesimi i menjëhershëm i transporteve publike favorizon lëvizshmërinë e qëndrueshme. Bashkëjetesa në lagje e hapësirave të dedikuara banimit, aktiviteteve dhe shërbimeve favorizon një përdorim të ekuilibruar të hapësirës së ndërtuar dhe eviton krijimin e zonave monofunkionale si përshembull zonat e biznesit që boshatisen tërësisht në momente të caktuara të ditës. Për të ndërthurur këto funksione të ndryshme, një kujdes të veçantë i duhet rezervuar rrjeteve të trafikut të ngadaltë në shkallë lokale (*rrugë këmbësorësh dhe biçikletash*) dhe ndërlidhjeve me zonat përreth. Një kujdes më i madh ndaj këmbësorëve influencon pozitivisht sigurinë e të gjithëve.

- **Cilësi e lartë mjedisore.**

Një lagje e qëndrueshme është e konceptuar në mënyrë për të ulur konsumin e burimeve të *papërtëritshme* (*terreni, energjia, uji, biodiversiteti*) dhe për të minimizuar impaktin e saj mbi mjedisin. Konkretisht, bëhet fjalë për të ndërmarrë zgjidhje arkitektonike, bioklimatike dhe teknologjike inovative, duke i dhënë rëndësi gjithashtu

edhe energjisë së ripërtëritshme (*dielli, druri, gjeotermia, biomasa*) dhe për të përdorur materiale që respektojnë mjedisin. Këto ndërhyrje përfshijnë edhe analizën e të gjithë ciklit jetësor të ndërtesave, monitorimin e performancës pa lënë mënjane sensibilizimin e përdoruesve ndaj këtyre tematikave.

▪ **Gjithëpërfshirje e brezave të ndryshëm dhe kohezioni social.**

Gjithëpërfshirje e brezave të ndryshëm dhe kohezioni social duhen favorizuar nga ndërmarrja e disa masave thelbësore: një jetë e lagjes e pasur dhe e ekuilibruar lehtëson bashkëjetesën ndërmjet banorëve. Klasifikimi i banesave në bazë të përmasave, llojit të hapësirës dhe standarteve, lejon që të kemi të bëjmë me një popullësi më të gjërë (*studentë, njerëz të vetmuar, familje, pensionistë, persona me aftësi të kufizuara, etj.*). Një kujdes të veçantë e meritojnë mundësitë në gjendje të favorizojnë bashkëjetesën ndërmjet brezave dhe kulturave të ndryshme si për shembull: strukturat për moshat parashkollore (*kopshtet, aktivitetet jashtëshkollore*), hapësirat e destinuara për të qenë një vend shkëmbimi mes banorëve (*qendrat e lagjeve, baret, hapësirat e takimeve, biblioteka, etj.*), ose aktivitetet zbavitëse (*hapësira kulturore, kopshte familiare, impiante sportive, etj.*).

▪ **Mirëqenie dhe bashkëjetesë.**

Krijimi i një lagjeje të qëndrueshme ka për synim përmirësimin e mirëqenies së përdoruesve të saj. Komforti zë pra një vend të rëndësishëm në projektimin e zonave të edificuara dhe jo. Të tjerë parametra cilësorë kontribuojnë në mënyrë të njëjtë për t'a bërë një shesh tërheqës dhe të jetueshëm, si përshembull: realizimi i hapësirave publike dhe të përbashkëta, takimet, shërbimet (*godina institucionale, qendra kulturore, aktivitete të vogla tregtare, parqe lojrash dhe zona zbavitëse*).

▪ **Menaxhimi i kostove.**

Realizueshmëria e këtyre projekteve varet gjithashtu nga menaxhimi i kostove të përgjithshme afatgjatë, domethënë nga një programim që të marrë parasysh jo vetëm fazat e ndërtimit, por edhe ato të përdorimit. Një menaxhim i keq i kostove penalizon ekuilibrin e gjithë operacionit për mungesë efikasiteti, dhe për shkaktimin e rrjedhjeve negative mbi bilancet e administratës publike.

▪ **Procesi i pjesëmarrjes.**

Konfirmimi i një projekti, përveç rrënjëzimit të tij në qytetin ku do të zbatohet, lehtësohet nëse lindin procese pjesëmarrëse që lejojnë vlerësimin me më shumë ndërgjegjshmëri të nevojave të banorëve. Mënyrat vepruese të procesit pjesëmarrës varen nga lloji i ndërhyrjes (*rigjallërim i një lagjeje ekzistuese, i një zone industriale të braktisur ose krijim i një lagjeje të re*). Sidoqoftë, ky proces duhet të përpiqet të përfshijë qysh në fillim subjektet kyç të projektit (*përfaqësues të autoriteteve, të shërbimeve administrative, të partnerëve privatë, ose të shoqatave të përfshira*). Si rrjedhojë, në përfundim strukturat në dispozicion ju ofrojnë banorëve mundësinë të marrin pjesë në mënyrë aktive në jetën e lagjes, duke favorizuar kështu identifikimin e tyre me hapësirën jetësore vetjake dhe bashkëjetesën harmonike në hapësirën urbane.

Në Evropë, nga disa projekte pilot në fazë zbatimi mund të citojmë në veçanti:

- Lagjja **Vauban** në Friburgo, Brisgovia (Gjermani), bazuar në rigjallërimin e kazermave ushtarake të ushtrisë franceze në jug të qendrës së qytetit: projekti është i përqëndruar nga një anë në uljen maksimale të impaktit mjedisor, nga ana tjetër në krijimin e një konteksti mikpritës që lehtëson marrëdhëniet shoqërore ndërmjet banorëve;
- Lagjja **BedZED**⁷¹ ndërtuar në një zonë qymyrbajtëse në jug të Londrës (Angli) përdor principet e shtëpisë ekologjike, duke kërkuar zgjedhje alternative kundrejt automjeteve për të reduktuar pluhurat dhe prodhimin e CO₂ (*dioksidi i karbonit*), dhe duke i dhënë rëndësi çështjes sociale;
- Lagjja **Solar City**, në jug të qytetit të Linz (Austri) propozon një kompleks të rëndësishëm vendbanimesh i frymëzuar nga disa aspekte të efikasitetit energjetik, të ndërtimit ekologjik dhe të lëvizshmërisë së qëndrueshme;
- Lagjja **Qyteti Diellor** (*Hammarby Sjöstad*), e ndërtuar në një zonë industriale portuale të braktisur në jug të Stokholmës (Suedi) me qëllim krijimin e një lagjeje me dendësi të lartë të ngjashme me qendrën e qytetit dhe përzierjen e kategorive të ndryshme shoqërore dhe profesionale;
- Lagjja **Eko Viki** (*Eco-Viikki*), një kompleks kompakt dhe miks, 8 km nga qendra e Helsinkit (Finlandë), i ideuar sipas një kualiteti të lartë mjedisor;
- Lagjet **Loreto**, **Myhlen** dhe **Francoziske Virtel** (*Loretto, Mühlen and Französische Viertel*) në Tubinga (Gjermani), të bazuara në një rikualifikim të zonave industriale dhe ushtarake të braktisura, janë rindërtuar sipas shumë principeve të qëndrueshmërisë duke nisur që nga pjesëmarrja e banorëve në projektimin e “*qyteti me rrugica të shkurtra*”.

Për t’ju përgjigjur në mënyrë të ndryshme sfidave të zhvillimit të qëndrueshëm, këto projekte përmbajnë karakteristika të veçanta dhe strategji ndërhyrëse specifike edhe pse aspektet mjedisore marrin në përgjithësi një rol kryesor. Megjithatë, del në pah që edhe pse në Evropë cilësia mjedisore e ndërtesave është në rritje progresive, shembujt e eko-lagjeve të qëndrueshme që integrojnë objektiva të qëndrueshëm dhe arkitekturë bashkëkohore janë ende të pakët dhe paraqiten si punë fillestare në këtë fushë.

Zvicra ka disa eksperiencë të avangardës në fushën e aplikimit të qëndrueshmërisë në shkallë lagjeje, ku citohen:

- Në Zvicrën gjermane mund të përmendim eksperiencën interesante të **Gundeldinger Feld** në Bazilea (*Basilea*). Bëhet fjalë për transformimin e një zone të vjetër industriale në një pol të ri urban sipas kriterëve ekologjike, sociale dhe ekonomike.

⁷¹ Beddington Zero Energy

Mbas rikualifikimit, ndërtesat industriale iu përshtatën funksioneve të reja. Që në ideimin fillestar të projektit, janë integruar tematika të ndryshme në lidhje me qëndrueshmërinë e lagjes që i referohen në përgjithësi çështjeve energjetike, flukseve të materialeve, ndërtimeve ekologjike, lëvizshmërisë dhe cilësisë së jetës⁷².

- Në Zvicrën Romande (franceze), lagja **Ekopark**, e realizuar krejtësisht në zonën e stacionit hekurudhor Nëshatel (*Neuchâtel*), ka ndjekur logjikën e një “laboratori” për zhvillimin urban të qëndrueshëm. Projekti, i nisur në fund të viteve ’90 mbas ndërtimit të Zyrës Federale të Statistikës, parashikon krijimin e një poli të ri urban me dendësi të lartë dhe mikse (*vendbanime, aktivitete, shkolla dhe dyqane në afërsi*) me akses të drejtpërdrejtë me transportin publik⁷³. Një numër i konsiderueshëm i kriterëve të qëndrueshmërisë është vënë në zbatim që në fazën e ndërtimit të lagjes falë vullnetit për të perfeksionuar qasjen ndërdisiplinore dhe vlerësuese. Gjatë një studimi shkencor PhD, është zhvilluar një sistem treguesish i quajtur **SIPRIUS** që ka ndihmuar në ndjekjen e punimeve për transformim e kësaj zone të vjetër hekurudhore në një lagje të qëndrueshme⁷⁴.
- Transformimi i Zonës Drajshpic në Bazilea dhe në Mynshinshtajn (*Dreisnitz in Basilea and Münchenstein*)
- Kooperativa e banimit Oberfeld në Ostermundigen afër Bernës, e destinuar për krijimin e një lagjeje pa automjete dhe energjikisht të pavarur.
- Eko-lagjet Zhonksion (*Jonction*) dhe Konkorde (*Concorde*) në Gjenevë.
- Eko-lagja Plenë dy Lup (*Plaines-du-Loup*), në fazë projektimi, e realizuar në kuadër të projektit “**Metamorfozë**” (*Métamorphose*) në Lozanë.
- Zona e Meli (*Malley*), projekti i së cilës bazohet në ndërhyrjen e nisur me stacionin e ri hekurudhor, do të zerë vend në zemër të një zone plot me ndryshime në përbërje të Lozanës.
- Zona Hunziker (*kooperativa Mehr-als-Wohnen*), lagja Manegg dhe godinat Sihlbogen në Zurich.

Duke qenë eksperiencë pilote në këtë fushë, këto projekte kanë nxjerrë në pah vështirësitë e këtyre ndërhyrjeve; duke rikualifikuar zonat urbane nisur nga integrimi i kriterëve të qëndrueshmërisë ato kanë arritur rezultate sasore se si qëndrueshmëria mund të hyjë me plot të drejtë mes parametrave thelbësorë të projekteve arkitektonike, pa hyrë në kontradiktë me vlerat cilësore të përshkruara kryesisht me nocionet e paraqitjes, kënaqësisë dhe urbanizimit⁷⁵. Realizimi i tyre ka treguar në të njëjtën kohë rëndësinë e komunikimit midis palëve të ndryshme të përfshira në projekt (*autoritetet, pronarët e tokave, banorët dhe*

⁷² Informacione të disponueshme në adresën www.gundeldingerfeld.ch.

⁷³ Bauart 2011

⁷⁴ Rey 2006

⁷⁵ Rëndësia e këtij dimension i cilësor që tejkalon performancat teknike mishërohet më së miri në nocionin e “komfort i mjaftueshëm”, shpikur nga Bruno Marchand në L’esprit de la ville (Marchand 2009).

specialistët). Secili nga këto projekte dëshmon dëshirën për integrim, si të kriterëve mjedisore, ashtu edhe ata të aspekteve sociale-kulturore dhe ekonomike⁷⁶.

Vlerësimi i Qëndrueshmërisë

Vlerësimi i qëndrueshmërisë mbështet proceset vendimtare dhe masat ndërhyrëse në kuadër të projekteve që kanë një ndikim domethënës tek më shumë se një dimension të zhvillimit të qëndrueshëm (figura 9). Pothuajse gjithmonë, bëhet fjalë për konflikt mes objektivave dhe interesave divergjentë që kërkojnë një vlerësim të përgjithshëm, një peshim të interesave, si dhe kërkimin e zgjedhjeve të duhura. Kjo është e rëndësishme veçanërisht në kuadër të projekteve afatgjatë që sjellin zotime të rëndësishme financiare.




Figura 9: Etapat e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë së një Projekti

Për çfarë shërben vlerësimi i qëndrueshmërisë?

- Për të identifikuar sa më shpejt të jetë e mundur pikat kryesore dhe pikat e dobëta të një projekti nga pikëpamja e zhvillimit të qëndrueshëm.
- Për të analizuar kostot, edhe ato afatgjata.
- Për të përmirësuar ose për të krahasuar mes tyre variantet e ndryshme të projektit.
- Për të përpunuar baza vendimarrëse të forta.
- Për të pasur argumenta që të justifikojnë projektin dhe t'a prezantojnë atë në mënyrën e duhur.

Për të garantuar një cilësi të përgjithshme të një projekti lagjeje është i nevojshëm integrimi i një numri të konsiderueshëm parametrash në procesin vendimtar që në fillësat e projektit. Suksesi i kësaj strategjie, që parashikon marrjen parasysh njëkohësisht të kriterëve mjedisore, ekonomike dhe social-kulturore duke përfshirë një bashkësi të madhe subjektsh, kërkon që kjo të mos kryhet në mënyrë sipërfaqësore apo të izoluar, por të bazohet në një mendim konstant nga ku mund të lindë një “*ripërshtatje*” e vazhdueshme dhe ripërsëritëse e projektit.

⁷⁶ Shoqëria në 2000 watt është një projekt i politeknikëve federalë. Aktualisht, në Zvicër konsumi i fuqisë së vazhdueshme për person arrin mesatarisht 6000 watt (përfshirë të gjitha llojet e energjisë). Qëllimi i Shoqërisë në 2000 watt është reduktimi i këtyre nevojave në 1/3-en e atyre aktuale, ku 500 watt mund të përfitohen nga burime energjetike të papërtëritshme.

Kjo sfidë nënkupton nevojën për të zotëruar informacione të sakta dhe të strukturuar në aftësinë e projektit për t’iu përgjigjur synimeve dhe aspekteve të formuluar. Duke vënë në dispozicion të ekspertëve dhe të autoriteteve vendimtarë udhëzime kostante mbi rezultatet e ndërmjetme, vlerësimi i projektit mund të jetë më efikas dhe të kontribuojë në ripërkufizimin e tij. Vlerësimi i themeluar në një metodologji koherente me shumëllojshmërinë e sfidave, luan një rol bashkangjithës të shumfishtë në lidhje me dinamikën e projektit⁷⁷:

- **Metodologji për analizën kritike, për verifikimin dhe vendimet.** Vlerësimi i bërë gjatë punimeve ofron disa informacione mbi projektin për t’u vënë në relacion me shumëllojshmërinë e perspektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Nga kjo pikëpamje ai u lejon grupeve të interesit të përfshirë një analizë të drejtpërdrejtë të ecurisë së projektit dhe lejon ndërmarrjen e vendimeve në mënyrë më të ndërgjegjshme.
- **Metodologji mbështetëse për zgjidhjen e problemeve.** Vlerësimi i fazës ekzekutuese ndihmon në zgjidhjen e problemeve falë informacioneve të çmuara që vë në dispozicion. Falë shumëllojshmërisë së mundësive dhe varianteve, rriten njohuritë mbi ecurinë e projektit dhe lehtësohet perfeksionimi i tij.
- **Metodologji komunikimi.** Dinamika e projekteve *lagje të qëndrueshme* bazohet pjesërisht në një komunikim më të ngushtë mes subjekteve të ndryshëm të interesuar. Nga kjo pikëpamje, vlerësimi i punës mund të përbëjë gjatë punimeve një mundësi interesante për të strukturuar dhe menaxhuar shkëmbimet mes bashkëbiseduesve, duke i dhënë hov edhe proceseve të tjera pjesëmarrëse.

Procesi i vlerësimit duhet të përfshihet qysh në fillim të projektit, sepse pikërisht në fazat fillestare bëhen zgjedhjet e rëndësishme për zhvillimin e tij. Këto etapa fillestare, ku liria për të manovruar për perfeksionizimin e projektit është më e madhe, i përputhen çuditërisht një fazë ende të pamaturuar përse i përket njohjes së parametrave të saj.

Me përparimin e projektimit dhe realizimin e veprës, njohuria rreth saj sa vjen e rritet por vendimet e marra në fazë fillestare ushtrojnë një ndikim gjithmonë e më të rëndësishëm duke limituar lirinë për manovrim dhe mundësitë për ripërkufizimin e projektit. Për të bërë zgjedhjet më të përshtatshme në çastin kur këto janë më ndikuese në përkufizimin e projektit, është e domosdoshme zotërimi i një sasive sa më të madhe të informacioneve mbi zhvillimin e tij. Për një realizim sa më të suksesshëm të synimeve të qëndrueshmërisë, është e nevojshme që procesi i vlerësimit të mos limitohet veç në fazat e ideimit. Vendime të shumta të marra në fazat e ideimit përcaktojnë njëzëri zhvillimet e ardhshme sepse rrjedhin nga orientimi në lidhje me shumëllojshmërinë e detajave të përpikta dhe me destinimin e zonave të ndërtuara

⁷⁷ Udhëzuesi “Evaluer la durabilité des projets dans les cantons et les communes” (ARE, 2007), ofron një vizion të përgjithshëm të qasjeve të ndryshme të mundshme.

dhe të pandërtuara. Kjo nevojë për kontroll (*ose monitorimi*) është veçanërisht kuptimplotë për projektet e lagjeve të qëndrueshme, duke konsideruar jetëgjatësinë e tyre.

Vlerësimi duhet idealisht të zhvillohet në disa faza kohore:

- **Vlerësimi fillestar.**

Në fazën e parë të projektimit, vlerësimi paraqitet si analizë e rezultateve të parashikuara të arritura me metodat e parashikimit dhe simulimet.

- **Vlerësimi i ndërmjetëm.**

Gjatë realizimit të projektit, vlerësimi përbëhet nga verifikimi i rregullt i rezultateve të projektit dhe nga një perfeksionim i këtij të fundit me korrigjimet e mundshme.

- **Vlerësimi përfundimtar.**

Në përfundim të realizimit të projektit, vlerësimi lejon shkrimin e një sinteze të karakteristikave të projektit duke nënvizuar aspektet një e nga një. Në rast se rezultatet janë të ndryshme nga synimet e paracaktuara, vlerësimi mund të lehtësojë arritjen e njohurive të reja veçanërisht të çmuara për etapat e ardhshme të projektit dhe në veçanti për veprimtaritë e tjera homologe.




Tabela 4: Fazat e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë

Zhvillimi i metodologjisë *Lagje të Qëndrueshme Zmeo*

Metodologjia **Zmeo** frymëzohet nga dy projekte, rezultatet e të cilëve kanë dhënë eksperiencë konkrete në këtë fushë:

- UFE dhe ARE kanë lançuar në vitin 2009 projektin kombëtar “*Lagje të Qëndrueshme*” bazuar në disa punë paraprake⁷⁸.
- Frut i një bashkëpunimi midis institucioneve të ndryshëm publikë, privatë dhe akademikë, projekti **Modeli ARE** i titulluar “*Des quartiers durables pour l’agglomération lausannoise*” ofron një pikëpamje interesante të sfidave gjatë punimeve në terren.

Një analizë e metodologjive ekzistuese ka treguar se si në shumë raste qasja ndaj ndërtimit të qëndrueshëm është shpesh e orientuar ndaj dimensionit mjedisor dhe më pak drejt atij social-kulturor dhe ekonomik. Nga ana tjetër, metodologjitë ekzistuese janë ideuar gati tërësisht për një ndërtesë të vetme dhe rrallë gjenden metodologji të përshtatshme për lagjen. Duke u nisur nga kjo premisë e dyanshme, një nga synimet kryesore të projektit kombëtar është ai i zhvillimit të një metodologjie ndihmëse për procesin vendimtar dhe e dobishme për një vlerësim të duhur të projektit në shkallë lagjeje, falë një qasjeje të tërthortë dhe të ekuilibruar të qëndrueshmërisë. Për këtë arsye, metodologjia referuese, Zmeo, e ideuar fillimisht për ndërtesat, u përshtat më tej për projektet eko-lagje⁷⁹. Për t’ju gjendur në ndihmë administratave publike që dëshirojnë të projektojnë ex-novo ose rikualifikojnë lagje sipas parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm, kjo lloj metodologjie duhet së pari të lejojë një analizë të drejtpërdrejtë, të bazuar në kritere cilësore dhe sasiore. Pas vlerësimit të projektit, përdoruesit e kësaj metodologjie duhet të jenë në gjendje të njohin pikat e forta për t’u vlerësuar dhe pikat e dobëta ku duhet ndërhyrë, me qëllim që masat e nevojshme për perfeksionim të merren në mënyrë specifike.

Metodologjia është ideuar për të qenë shumë elastike dhe e zbatueshme për një varg të gjatë projektesh lagjesh të qëndrueshme pavarësisht nga shkalla territoriale (*dimensioni i vendit*), nga lloji i ndërhyrjes së parashikuar (*ndërtimi, rikualifikimi, rishtrukturimi*) ose nga hetimi kohor (*fazat e zhvillimit të projektit*).

Akordimi i tabelës së kritereve të ideura dhe perfeksionuara falë bashkëpunimit me shumë partnerë dhe specialistë, i ka dhënë jetë një metodologjie të aftë të mbartë konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të përmbledhë në mënyrë sintetike kritere të rendit cilësor dhe sasior. Secilit prej këtyre kritereve i bashkangjitet një sërë pyetjesh që lejojnë vlerësimin nëse për secilin aspekt të trajtuar, ndërhyrjet e kryera dhe opsionet e përzgjedhura mund të aplikohen ose jo në perspektivë të qëndrueshmërisë.

⁷⁸ ARE, UFE, UFAB & novatlantis, 2007.

⁷⁹ Roulet & Liman, 2009.

Analiza e kriterëve të ndryshëm na lejon që të verifikojmë suksesin e projektit në lidhje me çdo dimension të marrë në konsideratë. Një analizë e bashkangjitur do të lejojë klasifikimin e rezultateve në bazë të etapave të ecurisë (*gjeneza, realizimi, përdorimi*) dhe do të japë një sintezë të fazave të projektimit (*projektimi, masterplani, plani i lagjes, realizimi, përdorimi*). Me metodën e analizës multikriteriale “**Hermione**”, e propozuar nga metodologjia Zmeo, mund të kryhet një analizë komplete cilësore dhe sasiore e një projekti në mënyrë që asnjë llogaritje subjektive të ndikojë në gjykim⁸⁰. Një përjasje e tillë pragmatike dhe transparente shtron bazat për një analizë të ekuilibruar të tre poleve të zhvillimit të qëndrueshëm.

Për të vlerësuar kriteret, Hermione përdor një tabelë bazë të ndarë në katër shkallë vlerësimi (*I kënaqshëm, I pasigurt, Ulët, Veto*), (figura 10). Vlerësimi i kriterëve cilësorë bazohet në një sërë argumentash; çdo ngjyrë i bashkangjitet një cilësi dhe vlerësuesi duhet të jetë në gjendje të justifikojë gjykimin e tij në mënyrë bindëse. Përsa i përket kriterëve sasiorë, është e rëndësishme përcaktimi i dy ose maksimumi tre prej tyre; i pari tregon limitin e mjaftueshmërisë, i dyti mjaftueshmërinë e plotë dhe i treti nëse e nevojshme papranueshmërinë. Bazuar në “**Parimin Kondorse**”⁸¹ (Condorcet), Hermion vlerëson kriteret e një analize në shkallë hierarkike (*sipas fushave specifike*) dhe përkthen rezultatet specifike të arritur në një ngjyrë (*jeshile, e verdhë, e kuqe*). Më tej, mbledh këto gjykime të pjesshme në një vlerësim global për t’ia paraqitur përdoruesit, një lloj vizioni sintetik dhe i koordinuar ky i nivelit të qëndrueshmërisë.




Figura 10: Vlerësimi i kriterëve cilësore dhe sasiore.

Për të favorizuar një shpërndarje dhe një zbatueshmëri në një shkallë të gjerë, metodologjia Zmeo është e disponueshme në internet në një platformë me akses të lirë. Ky program, me licence open source është gjithashtu i përdorshëm falas në sitin e internetit www.quartieri-sostenibili.ch e www.smeo.ch⁸². Promotorët e kësaj nisme synojnë të arrijnë qëllimin më ambicioz të projektit kombëtar “**Lagje të Qëndrueshme**”: favorizimi i

⁸⁰ Flourentzou 2003

⁸¹ Parimi Condorcet nënkupton që një vlerësim është në përgjithësi i favorshëm nëse shumica e secilit prej detajeve gjykohet në mënyrë të favorshme pa penalizuar fortësisht asnjë minorancë.

⁸² Me qëllim perfeksionizimin progresiv dhe shkëmbimin e njohurive, kodi kyç i programit është i disponueshëm sipas filozofisë së software të lirë General Public License (GPL) të Konferencës Zviceriane të Informatikës (CSI).

përfshirjes së tre dimensioneve të zhvillimit të qëndrueshëm në një numër sa më të madh projektesh për eko-lagje të qëndrueshme.

Kjo metodologji ka qenë subjekt testesh dhe diskutimesh në gjashtë zona pilot të karakterizuara nga faza të ndryshme zhvillimi. Kështu është bërë i mundur verifikimi i përshtatshmërisë në lidhje me fazat e ndryshme të evoluimit të projektit⁸³.

Test - 1. Zona e Drajshpic në Bazilea dhe në Mynshinshtajn (*Dreisnitz në Basilea dhe në Münchenstein*)

Zona e Drajshpic (*figurat 11, 12*), një zonë artizanale dhe industriale, do të transformohet në një lagje urbane me përdorim të shumëllojshëm për ndërmarrjet e shërbimeve, aktivitetet artizanale dhe industriale, banorët, aktivitetet kulturore dhe ato zbavitëse. Sipërfaqja prej 50 ha dhe pozicioni gjeografik (*vendodhja mes Kantonit të Bazileas-Qytet dhe komunës të Mynshinshtajn në Kantonin Bazilea-Fshat*) bëjnë që kjo zone të jetë një pol zhvillimi strategjik. Mundësitë për një rritje në të ardhmen janë marrë parasysh në një marrëveshje urbanistike të nënshkruar nga **Fondacioni Kristof Meriën** (*Christoph Merian*), (*pronarja e vetme e tokës*) dhe nga entet territoriale. Në zonën e ish-magazinave Frajlagë (*Freilager*) e cila përbën 10% të sipërfaqes totale të zonës, do të ndërtohet shkolla e mesme e Arteve të Bukura dhe Design si dhe do të integrohet një plan lagjeje. Ky plan parashikon një sërë objektivash të lidhur ngushtë me nocionin e lagjes së qëndrueshme (*domethënë: densiteti, përzierja, zhvillimi i hapësirave të gjelbërta dhe publike, përdorimi urban në shkallë njeriu*), pa harruar synimet përsa i përket energjisë dhe ndërtimeve.



Figurat 11, 12: Drajshpic në Bazilea dhe në Mynshinshtajn - Salla Drajshpic. Ark. Riter Giger Schmid (Ark. Ritter Giger Schmid)

⁸³ Adresat e kontakteve për secilën zonë pilot, në veçanti të përgjegjësve të projektit, janë të disponueshme në adresën: www.quartieri-sostenibili.ch

Test - 2. Lagjja Zhonsion, Gjenevë (*Jonction, Genève*)

Qyteti dhe Kantoni i Gjenevrës (*Figura 13, 14*) janë pionierët e këtij projekti eko-lagje që do të lindë në një terren ish-hapësirë industriale prej 2.5 ha. Qëllimi është krijimi i një lagjeje të re me cilësi urbanistike, arkitektonike dhe mjedisore që përfaqëson një model si nga ana mjedisore ashtu edhe nga ana e menaxhimit të lëvizshmërisë, polifunksionalitetit, përzierjes së hapësirave sociale dhe të brezave të ndryshëm. Projekti përfaqëson shumë forma përvetësimi për shkak të shumëllojshmërisë së apartamenteve të propozuara. Ky kujdes i veçantë i jepet marrëdhënieve ndërmjet ndërtimeve dhe hapësirave publike.



Figurat 13, 14: Lagjja Zhonsion, Gjenevë - Hapësira publike. Ark. Drajë Frincel (*Dreier Frenzel*)

Test - 3. Lagjja Ekopark, Nèshatel (Neuchâtel)

Me qëllim rritjen e dendësisë së territorit, projekti Ekopark (figurat 15, 16) parashikon krijimin e një lagjeje të re në zonën e vjetër hekurudhore pranë stacionit Nèshatel. Perimetri i tij përfshin godinën e Zyrës Federale të statistikës, ndërtesa të vjetra industriale të transformuara dhe ndërtesa të reja të destinuara për banim, formim shkollor, punë dhe biznes. Arkitektura e godinave i përshtatet atmosferës së vendit si nga volumi që ndërmerr formën e stacionit hekurudhor ashtu edhe nga forma dhe tipologjia që propozon hapësira të gjera të frymëzuara nga “loft”. Janë për t’u admiruar përpjekjet për të kufizuar konsumin energjetik, zgjedhja e kujdesshme e materialeve dhe kujdesi ndaj konfortit të banorëve. Shumëllojshmëria e tipologjive të banimit të propozuara sjell ndërmend një popullsi të përbërë nga shtresa me moshë të ndryshme. Kjo ndërhyrje e rëndësishme rikualifikimi urban që ka fituar çmimin ASPAN-SO 2007, është frut i bashkëpunimit të shumë partnerëve publikë dhe privatë.



Figurat 15, 16: Lagjja Ekopark, Nèshatel – Banesat. Ark. Bauart

Test - 4. Zona Bullingë, Zyrih (Bullinger, Zürich)

Zona Bullingë është pjesë e një lagjeje mjaft problematike (figurat 17, 18). Flitet për një nga zonat me dendësi më të madhe popullsie në qendër të qytetit të Zyrihut, ku përqëndrohet një pjesë e rëndësishme e imigrantëve dhe shtresave ekonomike më të dobëta. Transformimi i aksit të mëparshëm të trafikut (*Westtangente*) në një rrugë dytësore të lagjes lejon rritjen e cilësisë së jetesës në zonë. Rigjallërimi i sheshit Bullingë është realizuar duke përfshirë banorët përreth në plotësimin e masave për rikualifikimin ndërtimor.



Figurat 17, 18: Zona Bullingë, Zyrih - Parku publik në qendër të lagjes

Test - 5. Zona Meli në Lozanë, Prilij dhe Rinens (*Malley in Losanna, Prilly and Renens*)

Pllaja e Meli zë një sipërfaqe prej më shumë se 70 ha që shtrihet në komunat Lozanë, Prilij dhe Rinens (*figurat 19, 20*). Perimetri përfshin në veçanti zona të braktisura, terrene industriale, zona hekurudhore dhe një ndalesë të re për rrjetin e shpejtë rajonal. Zona me rreth 8000 banorë dhe vende pune është e destinuar që të transformohet në një hapësirë të preferuar mikse. Objektivat e qëndrueshmërisë janë integruar në skemën kryesore të kësaj zone me një zhvillim strategjik për çdo bashkësi⁸⁴.



Figurat 19, 20: Zona Meli në Lozanë, Prilij dhe Rinens - Pamje të realizuara në fazën e studimit. Ark. KCAP

⁸⁴ Bauart dhe al., 2011.

Test - 6. Lagjja Plenë dy Lu, Lozanë (Plaines-du-Loup, Losanna)

Lagjja Plenë dy Lu është një projekt i ideuar dhe zbatuar në qytetin Lozanë (Losanna) në kuadër të projektit **Metamorfozë** (*Métamorphose*) (figurat 21, 22). Ideja konsiston në krijimin e një “eko-lagjeje” të përbërë nga apartamente, aktivitete të ndryshme, shërbime dhe hapësira publike në disa terrene sportive në pjesën veriore të qytetit. Si rrjedhojë e një konkursi urbanistik në vitin 2010, janë në zhvillim e sipër studime specifike për përpunimin e një masterplani që do të shërbejë si themel për krijimin e planeve të pjesshme në të ardhmen. Vëmendja do t’i kushtohet përveçse llojeve të ndryshme të lëvizshmërisë (*transporti publik dhe individual, trafiku i ngadaltë*), edhe konkretizimit të planeve ambicioze energjetike dhe mjedisore.



Figurat 21, 22: Lagjja Lagjja Plenë dy Lu, Lozanë - Hapësira publike. Ark. TRIBU

Aplikimi i metodologjisë “Lagje të Qëndrueshme Zmeo”.

Në fillimin e një projekti janë thelbësorë dy kushte: **ideja fillestare** dhe **shtjellimi i dinamikës së brendshme**. Ideja në bazë të projektit duhet të jetë në gjendje të veprojë si “*detonator*”, një iniciativë e destinuar të vlerësojë zonat që paraqesin potencialitet interesant zhvillimi. Shumëllojshmëria e ideve që i japin jetë një projekti pasqyron përgjegjshmërinë e përbashkët të grupeve të përfshira (*ente publike, pronarë pasurish të patundëshme, ideatorë të projektit, investitorë, etj.*). Është efikasiteti i bashkëpunimit të tyre që influencon në mënyrë të rëndësishme nismëmarrjen e projektit. Enti publik i përgjegjshëm dhe pronari imobiliar mund të përshpejtojnë ose të bllokojnë projektin, dhe për këtë arsye marrin një rol vendimtar pikërisht në fazën fillestare.


Ecuria e brendshme e projektit i korrispondon konsolidimit të fazës fillestare, me fjalë të tjera ndërmarrjes konkrete nga ana e subjekteve të ndryshme të një strategjie të projektuar ndaj një të ardhmeje të zonës. Zhvillimi i një projekti të një lagjeje të qëndrueshme përfshin pra shumë grupe interesi të ndryshëm si: ente publike, pronarë tokash, planifikues, investitorë, ndërmarrje ndërtimi, si dhe përdorues dhe banorë të zonave limitrofe. Nga analiza e eksperiencave të ndryshme del në pah se ecuria e projektit është e lidhur me aftësinë e përgjegjës të projektit. Përcaktimi në kohë i objektivave të qëndrueshmërisë, shoqëruar nga një proces i rregullt vlerësimi, përbën një kusht thelbësor për ecurinë e projektit. Ky proces perfeksionizimi bazohet në një qasje bashkëpunimi ndërdisiplinor, ku kontributet e ndryshme ndërthuren dhe integrohen në mënyrë të përpiktë në projekt. Përgjegjësi i projektit duhet të ketë të gjitha këto cilësi: aftësi të madhe në integrimin e të dhënave multisektoriale, në menaxhimin e perspektivave dhe zotërimin e kompetencave të domosdoshme për projektin. Sipas këtij këndvështrimi, kjo metodologji i ofron përgjegjës të projektit si dhe të gjithë grupeve të interesit të përfshirë një mbështetje bazë për procesin vendimtar. Aktiviteti i një grupi kontrolli që ndjek hap mbas hapi zhvillimin e projektit, lejon vlerësimin e rezultateve të arritura, diskutimin e aspekteve problematike dhe përkufizimin në mënyrë të koordinuar të masave për t’u marrë me qëllim rritjen e qëndrueshmërisë. Priorja e një kuadri specifik për të diskutuar temat e qëndrueshmërisë favorizon pjesëmarrjen dhe ndarjen mes grupeve të interesit⁸⁵.

Për t’u përgjigjur nevojave lindur nga rritja e palëve të përfshira, vlerësimi dhe qëllimet e tij janë përshtatur herë pas here në baze të fazave të projektit, të llojit të investimit dhe të ndërhyrjes së parashikuar. Për të nxitur reflektimin afatgjatë, metodologjia është strukturuar sipas “*etapave të ciklit jetësor të lagjes*”.

Fazat e projektit eko-lagje të marra në vlerësim janë: **planifikimi, masterplani, plani i eko-lagjes, realizimi dhe përdorimi** (figurat 23, 24). Për secilën nga këto faza, mund të vlerësojmë dimensionet e nivelit përkatës të procesit dhe t’i krahasojmë me fazat e

⁸⁵ Një shembull i tillë eksperimental i “zhvillimit të qëndrueshëm” ka përfshirë disa grupe interesi në projektimin dhe realizimin e eko-lagjes Ecoparc a Neuchâtel (Guye & Rey, 2006).

mëparshme e të ardhshme. Në mikrokozmosin e eko-lagjes dallohen këto faza të ciklit jetësor:



Figurat 23, 24: Paraqitja skematike e ndarjes së propozuar nga metodologjia Zmeo (Sméo) në bazë të fazave të projektit dhe ciklit jetësor të lagjes.

- **gjeneza** (*momenti fillestar i konceptimit të projektit të eko-lagjes*)
- **realizimi** (*të gjithë aktorët e përfshirë në ndërtimin e eko-lagjes*)
- **përdorimi** (*faza e kohëzgjatjes së eko-lagjes*)
- **mirëmbajtja** (*elementët e ndërtimit dhe teknikat e instalimit*)
- **shpërbërja** (*faza e çmontimit dhe rekuperimit të materialeve*)

Fazat e projektit dhe të ciklit jetësor, kanë për qëllim t'i përgjigjen në mënyrë specifike nevojës për vlerësim të planifikuesve, duke mbajtur të pandryshuar qëllimin e qëndrueshmërisë afatgjatë. Kjo metodologji lejon realizimin e një analize të koordinuar në disa nivele duke integruar perspektivën e ciklit jetësor, fazat e projektit dhe nocionin e ekuilibrit mes dy dimensioneve të ndryshëm të qëndrueshmërisë. Kështu, bëhet i mundur një vlerësim kompleks i impaktit mjedisor, social dhe ekonomik të një ndërhyrjeje në çfarëdo fazë të projektit.

Tabela e vlerësimit është e strukturuar në disa fusha (*ose makro-kritere*) që përfshijnë dimensionin mjedisor, social-kulturor dhe ekonomik të një projekt-lagje. Secila prej këtyre fushave mbart me vete një sërë kriteresh të konsiderueshme që i korrispondojnë karakteristikave specifike të analizuara në perspektivë cilësore apo sasiore. *Tabela 5* propozon një vizion sintetik të kriterëve kryesorë të metodologjisë Zmeo.

Filozofia e metodologjisë risjell nocionet e fleksibilitetit dhe zhvillimit që garantojnë përshtatjen progresive në lidhje me përparimin e njohurive, eksperiencave dhe kompetencave në këtë fushë, gjithashtu dhe me ndryshimin e normave dhe bazave ligjore.

FAZAT E CIKLIT JETËSOR TË PROJEKTIT		
FAZAT	MAKRO-KRITERE	KRITERE
GJENEZA	Nevoja/ menaxhimi	Në përpunim e sipër
	Burime	Materialet Energjia Lëvizshmëria Terreni/Uji
	Sheshi/Arkitektura	Identiteti i sheshit të ndërtimit Kohëzgjatja
	Kolektiviteti	Përzierje Siguri/Komfort/Shëndet
	Kostot/financimet	Kostot/cikli jetësor Financime Aspekte lidhur me tokën
REALIZIMI	Terreni/Peizazhi	Përdorimi i terrenit Sipërfaqe të gjelbërta/biodiversiteti Regjimi i ujërave
	Infrastruktura	Burime energjetike Lëvizshmëria Ujërat dhe mbeturinat
	Projektimi i ndërtimit	Kompaktësia
	Materialet	Impakti mbi mjedisin
	Sasia e investimit	Në punim e sipër
PËRDORIMI	Bashkëjetesa	Integrim/kohezion Kontaktet sociale Solidariteti/drejtësia sociale Pjesëmarrja
	Identiteti	Ndjenja e përkatësisë
	Rrugët	Përzierja funksionale Lëvizshmëria/aksesibiliteti/përdorimi
	Siguria	Siguria e individëve Siguria e të mirave
	Komfort/shëndet	Zhurma/Dridhje Rrezatime
	Energjia	Ngrohja Uji i ngrohtë sanitar Klimatizimi Elektriciteti Impakti mbi mjedisin
	Uji/Mbeturinat	Ujëra shiu Mbledhje e diferenciuar e mbeturinave
	Kostot e zbatimit	Në përpunim e sipër
MIRËMBAJTJA	Elementët e ndërtimit Teknikat e instalimit	Etapë që i përket vetëm godinave
SHPËRBERJA	Shembja në fund të ciklit Faza e çmontimit dhe rekuperimit të materialeve	

Tabela 5: Tabela e përmblendhur e makro-kritereve dhe e kritereve të ciklit jetësor të projektit.

Përvoja e grumbulluar deri më tani tregon se vlerësimi i përdorur gjatë proceseve vendimtare dhe komunikuese është efikas sepse rezultatet prezantohen në mënyrë të arritshme nga përdorues të ndryshëm. Në fakt, përdoruesi ka mundësinë të vlerësojë projektin në mënyrë sintetike sipas fushave (*ose makro-kritereve*) ose të ndërmarrë një qasje më të detajuar me analizimin e rezultateve të pjesshme të vlerësimeve në funksion të fazave të ndryshme të ciklit jetësor të eko-lagjes dhe/ose të projektit. Pasi ka në dorë rezultatet, përdoruesi mund të identifikojë menjëherë pikat kryesore të projektit dhe aspektet që ende kanë nevojë për korrigjime. Në këtë fazë të analizës, përdoruesi mundet gjithashtu të përfitojë nga metodologjia për të nxjerrë përgjigje të tjera ose për të vënë në bashkëveprim rezultatet sintetike me detajin e vlerësimit. Nëse paraqiten shumë alternativa, përdoruesit i jepet mundësia për t'i krahasuar ato në mënyrë që të përzgjedhë atë më të qëndrueshme.

Kapitulli IV

HIPOTEZË APLIKIMI

4.1 Propozim i Lagjeve të Qëndrueshme në një zonë të degraduar të qytetit të Tiranës

Përshkrimi dhe Analiza e zonës në studim

Zona në studim shtrihet në veri të qytetit të Tiranës (figura 25); kufizohet në veri nga Lumi i Tiranës, në jug nga Unaza e Vogël, në lindje nga rruga Siri Kodra, në perëndim nga rruga Jordan Misja dhe ka një sipërfaqe rreth 102ha (figura 26).




Figura 25: Qyteti i Tiranës




Figura 26: Zona në studim

Nga një analizë tipologjike e zonës rezulton se në shumicën e ndërhyrjeve duket qartë përdorimi i një modeli arkitektonik i cili i është përshtatur mënyrës së shpejtë të konsumit, menaxhimit dhe ndërtimit të terrenit (figura 27).



Figura 27: Gjendja ekzistuese e zonës në studim, stacioni i trenit

Zona është zhvilluar pa hapësira publike, pa shërbime dhe as studime urbanistike të përshtatshme, me një rezidencë të paorganizuar ku përzihen forma dhe funksione tipike të një periferie, me një nivel të lartë degradimi fizik-funksional, mjedisor dhe social. Tipologjitë

dhe përdorimet janë mëse të ndryshme: ndërtime shumëkatëshe private, banesa tip vilë, kapanone publikë të braktisur e të shndërruar në punishte dhe magazina nga abusivë, baraka të përdorura si banesa dhe si kioska tregtare, baçe, fusha të pa mbjella, hapësira abuzive mbeturinash, etj. Nuk ka objekte të njohura me rëndësi kulturore (figura 28).



Figura 28: Gjendja ekzistuese e zonës në studim

Në jug të zonës përqëndrohet stacioni qendror i trenit, i cili aktualisht është në gjendje të avancuar degradimi, ashtu si dhe vetë rrjeti hekurudhor i cili përshkon të gjithë zonën (figura 29).



Figura 29: Gjendja ekzistuese e zonës në studim, rrjeti hekurudhor

Vetëm disa hapësira të vogla përreth zonës përshkohen nga një rrjet rrugor i asfaltuar; në pjesën më të madhe të zonës ai mungon ose është krijuar në mënyrë provizore nga kalimi i automjeteve për të mbërritur në destinacion. Mungon tërësisht ndriçimi rrugor, trotuarët dhe sinjalistika horizontale-vertikale. Në veri të zonës kalon Lumi i Tiranës krejtësisht i braktisur, cilësia e të cilit është prishur nga hedhja e paligjshme e mbeturinave inerte, e plehrave dhe shkarkimeve të ujrave të kanalizimeve (figura 30).



Figura 30: Gjendja ekzistuese e zonës në studim, lumi i Tiranës

Masterplani Qendror i Tiranës 2012, Arkitektët Grimshou (*Grimshaw Architects*)

Bazuar në problematikat e shumta të zonës, por sidomos në potencialin e saj për t'i dhënë një hov ekonomik e social qytetit në të ardhmen, Bashkia e Tiranës, në Maj të vitit 2012, shpalli një konkurs ndërkombëtar për studimin e rigjallërimit të kësaj zone ku morën pjesë disa nga studiot më prestigjioze në botë. Fitues u shpall **Studio Grimshaw Architects** dhe rezultati final ishte mjaft inkurajues dhe shpresëdhënës për thellimin e mëtejshëm të këtij studimi (*figura 31*).



Figura 31: Masterplani Qendror i Tiranës 2012, Grimshaw Architects




Figure 32: Masterplan Qendror i Tiranës 2012, Grimshaw Architects

Masterplan mbështet iniciativat e orientuara ndaj **urbanizimit cilësor**, ndaj rikualifikimit të zonave industriale të braktisura dhe ndaj vlerësimit të qendrave urbane. Interesant është fakti se studimi propozon realizimin e poleve urbane të dendura dhe të përziera, eko-lagje me një vizion global të qëndrueshëm (figura 32).

Projekti i propozuar “Lagje të Qëndrueshme në Tiranë”

Nëse kërkojmë termin “eko-lagje” në motorët e kërkimit në internet vërehet mungesa e prezencës së lagjeve të qëndrueshme në qytetet shqiptare. Situata ndryshon krejtësisht nëqoftëse kërkojmë termin francez “*écoquartier*”: i pari shfaqet në fakt përkufizimi i *écoquartier*⁸⁶ në Wikipedia, i ndjekur nga një sërë sitesh institucionale, organizatash dhe shoqatash evropiane, australiane dhe kanadeze, shenjë e një debati të ndezur kulturor dhe të një përhapjeje të gjerë të praktikave dhe metodologjive për zhvillimin e eko-lagjeve të qëndrueshme.

Në të gjithë qytetin, por sidomos në hapësirat urbane të degraduara, ekziston tashmë vullneti për të ndërhyrë sa më shpejt dhe me një nivel sa më të lartë profesionalizmi për t’i transformuar ato dhe për t’u dhënë funksione të reja.

“Bazuar në kërkesën e re emergjente social-kulturore, si t’a shndërrojmë qytetin e shpërhapur dhe kaotik në një qytet të qëndrueshëm dhe ekologjik?”

86 <http://fr.wikipedia.org/wiki/%C3%89coquartier>

Projekti lind me qëllim realizimin e një **kompleksi rezidencial** me efikasitet të lartë energjetik dhe impakt minimal mbi mjedisin me anë të integritit të një **“evolucioni idesh teknologjike”** si: materiale të qëndrueshme dhe të riciklueshme, efikasitet i sistemeve të ventilimit dhe ftohjes, panele diellore, turbina me erë, menaxhim i mbeturinave, riciklim i ujrave të shiut etj, por dhe me anë të shfrytëzimit maksimal të elementëve natyrorë si elementë moderatorë të mikroklimës, të zhurmave dhe përmirësimit të cilësisë së ajrit. Rezultati: **“eko-lagje”**, lagje të qëndrueshme të projektuara në mënyrë për të garantuar një komfort jo vetëm në brendësi të banesës, por edhe në brendësi të lagjes. Kjo e gjitha do të ketë ndikim pozitiv në përmirësimin e jetesës dhe të ekonomisë në këtë zonë. Një qasje inovative ndaj zhvillimit të qëndrueshëm sjell vlerësimin jo vetëm të aspekteve arkitektonike dhe energjetike, por edhe kërkimin e një ekuilibri të aspekteve sociale si integrimi, dhe siguria kundrejt lëvizshmërisë, respektin ndaj mjedisit dhe formës urbane.

Kjo do të jetë një *lagje-pilot* që do të ofrojë mundësinë e aplikimit të këtyre teorive arkitektonike.

Nga pikëpamja e pozicionimit, projekti mban logjikën **“ndërtesë/truall”** duke synuar përkufizimin e një hapësire kolektive të hapur të shndërruar kështu në një vend kolektiv, me hapësirat e veta plote dhe boshe, plot me lëvizje dhe marrëdhënie. Kjo bashkësi na lejon të ofrojmë, pikërisht në afërsi të banesës, shërbimet e nevojshme të jetesës së përditëshme duke shtyrë banorët që të evitojnë përdorimin e automjetit dhe të levizin më këmbë. Projekti bazohet në strategjinë e zhvillimit të qëndrueshëm duke u mbështetur në kriteret e qëndrueshmërisë që rrjedhin nga tre dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm (tabela 6).

KRITERET E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM		
MJEDISI	EKONOMIA	SHOQËRIA
Mbrojtja e hapësirave natyrore dhe shumëllojshmëria e specieve.	Garantimi i të ardhurave, punësimit dhe rritja e tyre sipas nevojave, duke pasur parasysh një shpërndarje të përputhshme me nevojat sociale dhe territoriale.	Tutelim dhe inkurajim i shëndetit dhe sigurisë së banorëve.
Mbajtja e konsumit të burimeve të ripërtëritshme nën nivelin e rigjenerimit ose të disponibilitetit natyror.	Mbrojtja dhe përmirësim i kapitalit prodhues të bazuar në burimet sociale dhe humane	Garantim i arsimimit, si edhe i zhvillimit ose më mirë i shprehjes së plotë të identitetit të çdo individi
Mbajtja e konsumit të burimeve të papërtëritshme nën potencialin e zhvillimit të burimeve të ripërtëritshme.	Përmirësim i konkurrencës dhe aftësisë inovative të ekonomisë.	Inkurajim i kulturës, mbrojtja dhe zhvillim i vlerave të burimeve shoqërore të nënkuptuara si pasuri e shoqërisë.
Ulje të ndotjes për shkak të emetimeve (<i>lëndë të dëmshme</i>) në një nivel të padëmshëm për mjedisin dhe për njeriun.	Në ekonomi, t’i jepet përparësi mekanizmave të tregut (<i>çmime</i>) duke pasur parasysh faktorët shkaktarë të mungesës dhe kostove të jashtme.	Garantim i të drejtave të barabarta për të gjithë dhe siguri për të drejtën (<i>barazi gjinore, tutelë e minorancave si edhe njohje e të drejtave të njeriut</i>).
Ulje e efekteve të katastrofave mjedisore.	Inkurajim i një menaxhimi nga ana e banorëve pa dëmtuar brezat e ardhshëm.	Inkurajim i solidaritetit ndërbrezor si edhe atij global.

Tabela 6: Kriteret e qëndrueshmërisë ku mbështetet ideimi i projektit

PROGRAMI - DETYRA E PROJEKTIMIT
Shembull - 1
BANIMI 3-4-5kt + 1kt nën tokë

Tipologjia	Sasia	Sip m ²	Sip T m ²	Lartësia	Vol m ³	Vol T m ³	Nr vend.
Apartamente tip Garsonier	12	18	216	2.7	48.6	583.2	
Apartamente tip 1+1	66	48	3168	2.7	129.6	8553.6	
Apartamente tip 2+1	82	72	5904	2.7	194.4	15940.8	
Apartamente tip 3+1	12	96	1152	2.7	259.2	3110.4	
Apartamente Dupleks 3+1	14	112	1568	2.85	319.2	4468.8	
Hapësira shërbyese			1287	2.7		3474.9	
Ambiente biznesi (ap)			573	3.5		2005.5	
Tarraca të gjelbëruara			532				

Sip. Tot. Rezidenciale mbi tokë = 14400 m²
Vol. Tot. Rezidenciale mbi tokë = 38137.2 m³
Njolla e ndërtimit = 35% = 2880 m²
Sip. Tot. e sheshit = 8229 m²
Sipërfaqet dhe Volumet nën tokë

Parking i brendshëm rezidenca			1860	2.5		4650	186
Hapësira depo			758	2.5		1895	
Hapësira teknike			486	2.5		1215	
Hapësira kalimi nën tokë			1763	2.5		4407.5	

Sip. Tot. Rezidenciale nën tokë = 4867 m²
Vol. Tot. Rezidenciale nën tokë = 12167.5 m³
Sipërfaqet e hapësirave të jashtme

Ambiente të gjelbërta			4194				
Parking i jashtëm rezidenca			320				32
Parking Persona me aftësi të kuf.			37.5				3
Pistë biçikletash			0				
Kënd lojrash			483				
Basene ujore			0				
Rrugë këmbësorësh - trotuare			315				

Sip. Tot. e Sistemit = 5349.5 m²
Nr. i banorëve

Nr. Tot i Ban. 66-90 vjeç	13						
Nr. Tot i Ban. 26-65 vjeç	71						
Nr. Tot i Ban. 18-25 vjeç	58						
Nr. Tot i Ban. 0-17 vjeç	35						

Nr. Tot. i banorëve = 177
Nr. i punëtorëve

Nr. Tot. Mirëmbajtja	6						
Nr. Tot. Bizneset	13						

Tabela 7: Programi – Detyra e Projektimit për pjesën e banimit të ulët

EKO - TOWER (6kt banim + 8kt Mixed use + 3kt nën tokë)

Tipologjia	Sasia	Sip m ²	Sip T m ²	Lartësia	Vol m ³	Vol T m ³	Nr vend.
Apartamente tip 2+1	14	92	1288	2.85	262.2	3670.8	
Apartamente tip 3+1	7	116	812	2.85	330.6	2314.2	
Apartamente Duplex 4+1	7	132	924	2.85	376.2	2633.4	
Hapësira shërbyese të apartam.			315	2.85		897.75	
Zyra + Ambiente shërbimi			2172	4.2		9122.4	
Ambiente Sportive			937	4.2		3935.4	
Ambiente rekreacioni			1821	4.2		7648.2	
Tarraca të gjelbëruara			247				

Sip. Tot. Rez. + Mixed use = 8516 m²

Vol. Tot. Rez. + Mixed use = 30222.15 m³

Njolla e ndërtimit = 50% = 782 m²

Sip. Tot. e sheshit = 1564 m²

Sipërfaqet dhe Volumet nën tokë

Parking i brendshëm rezidenca			540	2.5		1350	54
Parking i brendshëm zyrat			1020	2.5		2550	102
Hapësira teknike			739	2.5		1847.5	
Hapësira kalimi nën tokë			1213	2.5		3032.5	

Sip. Tot. Rezidenciale nën tokë = 3512 m²

Vol. Tot. Rezidenciale nën tokë = 8780 m³

Sipërfaqet e hapësirave të jashtme

Ambiente të gjelbërta			359				
Parking Persona me aftësi të kuf.			25				2
Parking i jashtëm zyrat			180				18
Pistë biçikletash			97				
Rrugë këmbësorësh - trotuare			121				

Sip. Tot. e Sistemit = 782 m²

Nr. i banorëve

Nr. Tot i Ban. 66-90 vjeç	9						
Nr. Tot i Ban. 26-65 vjeç	36						
Nr. Tot i Ban. 18-25 vjeç	33						
Nr. Tot i Ban. 0-17 vjeç	23						

Nr. Tot. i banorëve = 101

Nr. i punëtorëve

Nr. Tot. Mirëmbajtja	19						
Nr. Tot. Biznesi	347						

Tabela 8: Programi – Detyra e Projektimit për Eko-Tower

Shembull 1: Eco-Lagje e Qëndrueshme 1




Figura 33: Projekt-ide, Lagje e Qëndrueshme në Masterplanin e Grimshaw.
 UPT - FAU Lektor E. Gjoka, Studentët: E. Disha, D. Sako.



Figura 34: Sheshi i ndërtimit

BANIMI 3-4-5kt + 1kt nën tokë

Tipologjia	Sasia	Sip m ²	Sip T m ²	Lartësia	Vol m ³	Vol T m ³	Nr vend.
Apartamente tip Garsonier	20	18	360	2.7	48.6	972	
Apartamente tip 1+1	64	48	3072	2.7	129.6	8294.4	
Apartamente tip 2+1	84	72	6048	2.7	194.4	16329.6	
Apartamente tip 3+1	16	96	1536	2.7	259.2	4147.2	
Apartamente Dupleks 3+1	12	112	1344	2.85	319.2	3830.4	
Hapësira shërbyese			1380	2.7		3726	
Ambiente biznesi (ap)			672	3.5		2352	
Tarraca të gjelbëruara			1653				

Sip. Tot. Rezidenciale mbi tokë = 16065 m²Vol. Tot. Rezidenciale mbi tokë = 39651.6 m³Njolla e ndërtimit = 35% = 3570 m²Sip. Tot. e sheshit = 10200 m²**Sipërfaqet dhe Volumet nën tokë**

Parking i brendshëm residenca			2140	2.5		5350	214
Hapësira depo			816	2.5		2040	
Hapësira teknike			522	2.5		1305	
Hapësira kalimi nën toke			1920	2.5		4800	

Sip. Tot. Rezidenciale nën tokë = 5398 m²Vol. Tot. Rezidenciale nën tokë = 13495 m³**Sipërfaqet e hapësirave të jashtme**

Ambiente të gjelbërta			4521				
Parking i jashtëm rezidenca			370				37
Parking Persona me aftësi të kuf.			50				4
Pistë biçikletash			586				
Kënd lojrash			632				
Basene ujore			187				
Rrugë këmbësorësh - trotuare			284				

Sip. Tot. e Sistemit = 6630 m²**Nr. i banorëve**

Nr. Tot i Ban. 66-90 vjeç	15						
Nr. Tot i Ban. 26-65 vjeç	75						
Nr. Tot i Ban. 18-25 vjeç	64						
Nr. Tot i Ban. 0-17 vjeç	42						

Nr. Tot. i banorëve = 196

Nr. i punëtorëve

Nr. Tot. Mirëmbajtja	7						
Nr. Tot. Biznesi	15						

Tabela 9: Programi – Detyra e Projektimit për pjesën e banimit të ulët

EKO - TOWER (6kt banim + 6kt Mixed use + 3kt nën tokë)

Tipologjia	Sasia	Sip m ²	Sip T m ²	Lartesia	Vol m ³	Vol T m ³	Nr vend.
Apartamente tip 2+1	10	92	920	2.85	262.2	2622	
Apartamente tip 3+1	6	116	696	2.85	330.6	1983.6	
Apartamente Duplex 4+1	4	132	528	2.85	376.2	1504.8	
Hapësira shërbyese të apartam.			210	2.85		598.5	
Zyra + Ambjente shërbimi			1132	4.2		4754.4	
Ambjente Sportive			766	4.2		3217.2	
Ambjente rikreacioni			1236	4.2		5191.2	
Tarraca të gjelbëruara			752				

Sip. Tot. Rez. + Mixed use = 6240 m²

Vol. Tot. Rez. + Mixed use = 19871.7 m³

Njolla e ndërtimit = 50% = 520 m²

Sip. Tot. e sheshit = 1040 m²

Sipërfaqet dhe Volumet nën tokë

Parking i brendshëm rezidenca			400	2.5		1000	40
Parking i brendshëm zyrat			800	2.5		2000	80
